# Raporti Vjetor
# 2022

RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS • KOSOVO WOMEN'S NETWORK • MREŽA ŽENA KOSOVA

# Rrjeti i Grave të Kosovës

# Raporti Vjetor 2022

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar burimin.

*Ky raport është përgatitur nga anëtaret e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga Bashkimi Evropian (BE), Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), UN Women, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Sweden Sverige, dhe Sigrid Rausing Trust si përgjegjësi e RrGK-së për të raportuar tek organizatat anëtare të saj. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartpërmendur.*

www.womensnetwork.org

# Përmbajtja

Hyrje ........ 6
Vizioni ynë ........ 6
Misioni ynë ........ 6
Strategjia jonë ........ 7
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së ........ 7

Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë ........ 8
Krijimi dhe zbatimi i një strategjie për përparimin e lëvizjes feministe ........ 9
Rritja e solidaritetit ndërmjet organizatave të grave ........ 10
Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre ........ 13
*Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave* ........ 25

Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje ........ 28
Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%) ........ 31
Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OSHCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE ........ 43
Përmirësimi i integrimit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre ........ 51

Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II dhe III....54
**Përmirësimi i hartimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II....57**

Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor....59
**Rritet llogaridhënia e zyrtarëve publik dhe institucioneve shëndetësore në adresimin e shkeljeve të të drejtave të grave në kujdesin shëndetësor....59**
**Rritja e qasjes së grave në kujdes shëndetësor....60**

Jeta pa dhunë me bazë gjinore....62

**Përmirësimi i zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në familje, duke përfshirë përgjegjësinë institucionale për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë....63**

Fuqizimi Ekonomik i Grave....77
**Përmirësimi i kurrikulës dhe teksteve shkollore nga perspektiva gjinore....89**

Vlerësimi i punës së RrGK-së....91

Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2022....95

....101

....102

Rreth nesh....103

Bordi i Drejtorëve të RrGK-së ........ 103
Bordi Këshillëdhënës i RrGK-së ........ 103
Stafi i RrGK-së në vitin 2022 ........ 103
Organizatat anëtare të RrGK-së në vitin 2022 ........ 106
Shtojca 1a. Lista e granteve që janë përmbyllur me sukses gjatë vitit 2022 ........ 126
Shtojca 1b. Grantet e ndara në vitin 2022 ........ 149

# Hyrje

## Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka vizion një Kosovë në të cilën gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe jetë pa dhunë.

## Misioni ynë

Misioni i Rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, fetare, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual, dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve e rrjetëzimeve, si dhe përmes hulumtimeve, avokimit e shërbimeve.

## Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e tij, RrGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2019-2022 (të cilën mund ta gjeni në ueb-faqen e RrGK-së). Qëllimi i kësaj strategjie është ta drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2018 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, Bordi i Drejtorëve, partnerët, dhe palët e tjera relevante. Kjo strategji e RrGK-së është e ndarë në gjashtë fusha programore: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe vendimmarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore, V) Fuqizimi ekonomik i grave, si dhe VI) Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

Në vitin 2022, RrGK ka nisur planifikimin e Strategjisë së re të RrGK për vitet 2023-2026 përmes një takimi një ditor me anëtaret e saj me gjashtë qershor. Pas mbledhjes së të dhënave dhe me kontributin e anëtareve për ta plotësuar Strategjinë, RrGK ka mbajtur takimin e dytë me 16 nëntor, ku së bashku me anëtaret dhe bashkëpunëtorët kyç ka finalizuar Strategjinë. Anëtaret e RrGK-së vendosën që Strategjia e RrGK për vitet 2023-2026 do të përfshijë fushat programatike në vijim: I) Përmirësimi i Barazisë Gjinore përmes Sundimit të Ligjit; II) Jeta pa dhunë me bazë gjinore; III) Fuqizimi Ekonomik i Grave; IV) Edukimi që transformon normat gjinore; përfshirë qasjen ndërlidhëse ku hyjnë Fuqizimi i Lëvizjes Feministe, Ndryshimet Klimatike dhe Mbrojtja e Mjedisit.

## Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit Rrjeti raporton te organizatat anëtare, partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport përmban informata nga 1 janar deri me 31 dhjetor 2022.

Ky raport është i ndarë gjashtë pjesë bazuar në gjashtë programet e lartcekura të RrGK-së dhe qëllimet afatgjata të tyre:

- Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
- Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
- Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
- Fuqizimi ekonomik i grave;
- Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2022 për secilin nga këto programe. Përgjatë këtij raporti, prezantohet edhe progresi i arritur për tërë strategjinë nga viti 2019 deri në vitin 2022, si dhe aty ku ka numërime që nga viti 2015 ose më herët. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, bordit të drejtorëve dhe atij këshillëdhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve si dhe përfituesve të granteve.

# Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë

Qëllimi kryesor i këtij objektivi është që të fuqizohet lëvizja feministe në Kosovë dhe në

rajonin e Ballkanit Perëndimor. Siç tregohet edhe nga treguesit e mëposhtëm, RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij objektivi:

- RrGK ka zbatuar më shumë se 83% të Strategjisë;
- Gratë dhe burrat kanë ndërmarrë 35 iniciativa në 2022, kurse 87 gjithsej që nga viti 2015, për të mbështetur lëvizjen e grave, duke dëshmuar kështu që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitet që të vazhdojnë këtë punë; dhe
- Anëtaret e RrGK-së dhe Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë kanë vazhduar të jenë aktive dhe të zëshme.

Për realizimin e këtij qëllimi afatgjatë, është bërë përparim drejt objektivave të renditura më poshtë, të cilat janë të detajuara në tituj. Objektivat specifike dhe çdo përparim drejt tyre, domethënë rezultate, janë të paraqitura më poshtë në titujt me shkronja të theksuara. Rezultatet e arritura janë të paraqitura me shkronja të theksuara dhe të pjerrëta.

## Krijimi dhe zbatimi i një strategjie për përparimin e lëvizjes feministe

Në vitin 2021, RrGK organizoi punëtori për planifikimin e strategjisë feministe, në Durrës, Shqipëri, ku më shumë se 100 organizata anëtare të RrGK punuan së bashku për hartimin e strategjisë feministe. Kjo strategji e cila u finalizua gjatë vitit 2022, është pjesë e strategjisë së re të RrGK për vitet 2023-2026. Këtë proces e ka mbështetur Fondacioni Kvinna till Kvinna.

## Rritja e solidaritetit ndërmjet organizatave të grave

Përvoja e RrGK-së sugjeron se mbështetja dhe ruajtja e solidaritet ndërmjet organizatave të grave janë jetike në krijimin e një lëvizjeje feministe të qëndrueshme. Në këtë drejtim, RrGK ka shënuar përparim drejt arritjes së objektivave të vitit 2022. RrGK ka vazhduar partneritetin me organizatat për të drejtat e grave në rajon përmes pjesëmarrjes së saj në gjashtë koalicione rajonale ndëretnike.

## Anëtaret e RrGK-së të informuara për nismat e anëtareve të tjera, aktivitetet e RrGK-së, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

RrGK ka vazhduar të informojë anëtarët e saj për nismat, aktivitetet e RrGK-së dhe mundësitë për përfitim të fondeve. RrGK mbajti pesë takime të anëtareve, ku 83 anëtare, partnerë dhe mbështetës të ndryshëm shkëmbyen informata dhe u njoftuan për aktivitetet e vazhdueshme të RrGK-së dhe organizatave të tjera anëtare. Që nga viti 2015, gjithsej 1,427 gra dhe burra kanë marrë pjesë në takimet e RrGK-së. Gjatë këtyre takimeve, anëtaret e RrGK-së luajtën një rol të rëndësishëm në zbatimin e përbashkët të strategjisë, diskutimin e zhvillimeve socio-politike në Kosovë, si dhe në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.



*Anëtaret e RrGK-së bashkëpunojnë në hartimin e strategjisë së RrGK-së, Prishtinë, qershor 2022*

### Më shumë aktivistë dhe aktiviste të përfshirë në lëvizjen feministe

Gjatë vitit 2022, RrGK ka angazhuar rreth 43 vajza dhe djem përmes punës vullnetare, Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë, partnereve dhe aktiviteteve të tjera. Në mbledhjet dhe në punëtoritë e organizuara nga RrGK kanë marrë pjesë 24 të rinjë dhe të reja. Ndërsa që nga numërimi, RrGK ka angazhuar në total mbi 7,276 vajza dhe djem në lëvizjen feministe. Kjo u ka dhënë atyre mundësi që të përfitojnë më shumë aftësi rreth organizimit, hulumtimit, avokimit, integrimit të çështjeve gjinore në avokimet për të drejtat e njeriut, monitorimin e seancave gjyqësore, dhunës me bazë gjinore, si dhe çështjeve të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Angazhimi i më shumë të rinjve në këto përpjekje mund të ndihmojë në fuqizimin e lëvizjes feministe në Kosovë.

### Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile

Që nga viti 2015, RrGK dhe anëtaret e saj janë përfshirë në 171 nisma ndëretnike. Vetëm në vitin 2022 , RrGK dhe anëtaret e saj kanë qenë të përfshira në dymbëdhjetë nisma ndëretnike. RrGK ka vazhduar partneritetet e saj ndëretnike në rajon përmes Koalicionit për Adresimin e Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë në BP; partneritete me organizata që synojnë integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) përmes koalicionit EQUAPRO; me Rrjetin Mbikëqyrës të Buxhetimit Gjinor (RrMBGj), nismë e përbashkët e organizatave partnere në Ballkanin Perëndimor dhe në Republikën e Moldavisë, që kërkon të institucionalizojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; dhe një rrjet organizatash që hulumtojnë fondet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave; dhe Rrjeti Kundër Dhunës

me Bazë Gjinore në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë këtu organizata të shoqërisë civile nga pesë shtetet për përmirësimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrimit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. RrGK është në finalizim të procedurave për t'u anëtarësuar në rrjetin evropian "Gratë Kundër Dhunës". Gjithashtu, RrGK ishte pjesë e Komitetit për të Drejtat e Njeriut, një grup ky i organizatave të shoqërisë civile i cili çdo vit mbikëqyrë dhe raporton për të drejtat e njeriut në Kosovë nga perspektiva e shoqërisë civile.

## Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtaret e saj që e mbajnë të gjallë atë. RrGK ka mbështetur anëtaret e veta në avancimin e kapaciteteve të tyre organizative dhe të avokimit, përmes mentorimit personal dhe Fondit të Grave të Kosovës.

Rrjeti ka vazhduar Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese për të vlerësuar kapacitetet e organizatave anëtare që përfitojnë grante. Gjatë vitit 2021, RrGK ka bashkëpunuar me 63 organizata në Kosovë për Zhvillimin e Kapaciteteve, të përshtatshme për çdo organizatë. RrGK po vazhdon t'i mbështes këto 27 nga këto organizata të cilat janë duke implementuar iniciativa në zbatimin e planeve të tyre. Ndërsa që nga viti 2013, RrGK ka bashkëpunuar me 149 organizata në Kosovë dhe rajon për Zhvillimin e kapaciteteve.

***RrGK, anëtaret e saj dhe puna e tyremë e dukshme për partnerët e mundshëm, aktivistet ndërkombëtare dhe mbështetësit e mundshëm***

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGK-së, në faqen në Facebook, Twitter, Instagram, dhe në buletinin elektronik mujor "Zëri i Grave Kosovare". RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 19,919 në 2019 në 24,805 në 2022. Kurse, në Twitter dhe Instagram, numri i ndjekësve është rritur nga 780 në 1,544, përkatësisht nga 1,279 në 3,201. Gjithashtu, 955 persona e pranojnë përmes emailit buletinin "Zëri i Grave Kosovare". Në vitin 2022, RrGK ka pasur 160 paraqitje në media dhe ka dërguar 24 kumtesa për media, duke përfshirë:

1. RrGK kërkon dënim maksimal për vrasjen e gruas nga bashkëshorti në Llaushë
2. Nisma rajonale "Avancimi i Barazisë Gjinore përmes procesit të anëtarësimit në BE" ndan 30 grante
3. Fondi i Grave të Kosovës ndan mbi 276,000€ për 28 organizata dhe strehimore në Kosovë
4. RrGK lanson raportin "Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi ne Kosovë"
5. RrGK lanson raportin "Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë
6. RrGK dënon gjuhën diskriminuese dhe seksiste të Matoshit
7. Rrjeti i Grave të Kosovës organizon ekspozitën "Dhuna nuk fshehet mrena mureve"
8. RrGK kërkon shqiptimin e masës së paraburgimit për të dyshuarin e dhunimit seksual të së miturës
9. Koalicioni i Ballkanit Perëndimor publikon Raportin Rajonal mbi Diskriminimin me Bazë Gjinore dhe Punësimin

10. RrGK me rekomandime për heqjen e taksave në produktet menstruale
11. RrGK prezanton rekomandimet mbi politikat gjinore për personat me aftësi të kufizuara
12. RrGK dhe Strehimoret reagojnë në komentet e KGJK-së e KPK-së për punën e organizatave joqeveritare
13. Vazhdon abuzimi sistematik i të miturave në Kosovë – aktgjykimi shqetësues shpërfaq neglizhencën institucionale ndaj abuzimit seksual të së miturës 8 vjeçare
14. Reagon RrGK: Të caktohet masa e sigurisë dhe të shkarkohet nga rolet udhëheqëse gazetari Arben Ahmeti
15. Përmbledhja e re e politikave: Kostot e lehonisë, atësisë dhe dispozitave të lejes prindërore për Ligjin e ri të Punës në Kosovë
16. RrGK mirëpret aprovimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale
17. RrGK: Letër avokuese për buxhetin për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe QPS-të
18. RrGK lanson librin Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325 në kuadër të Forumit Presidencial
19. RrGK dënon fuqishëm gjuhën denigruese dhe shantazhuese ndaj znj Luljeta Plakolli Kasumi
20. RrGK kërkon t'u hiqet licenca infermiereve dhe të marrin dënimin meritor konform ligjeve
21. OSHCG-të bëjnë thirrje për përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin e Berlinit
22. RrGK reagon ndaj zbutjes së dënimit të Naser Pajazitajt

23. RrGK shpreh dëshpërim të thellë për vrasjen e 63 vjeçares nga bashkëshorti: kërkon zgjim institucional dhe social
24. RrGK mbajti Kuvendin e 20-të vjetor

Që kur RrGK ka filluar numërimin në vitin 2019, ne kemi pasur1,820 paraqitje në media dhe ka dërguar 120 kumtesa për media që nga viti 2019.

***Më shumë anëtare kërkojnë fonde, planifikojnë në mënyrë efektive, udhëheqin organizata dhe ndërmarrin nisma efektive avokuese***

Individualisht, 28 anëtare të RrGK-së të cilët mbështeten përmes FGK-së kanë përfunduar 39 projekte/grante me sukses gjatë vitit 2022. Më tej, anëtaret ndërmoren 71 iniciativa avokuese me mbështetjen e RrGK-së, duke dëshmuar rritjen e kapaciteteve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave. Iniciativat e anëtareve përfshinin 99 takime me zyrtarë drejt mbështetjes, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave. Përpjekjet avokuese të përfituesve të granteve nga FGK-a rezultuan në katër ndryshime politikash, të udhëhequra nga Glas Zena Partes, Down Syndrome Kosova dheShoqata Rinore për të Drejtat e Njeriut YAHR . Këto politika kanë ndikuar pozitivisht tek të drejtat e grave dhe vajzave.

Përveç mbështetjes së ofruar organizatave të saj anëtare,RrGK ka ndarë 27 grante për 18 OShC përmes FGK-së, në vlerë prej266,986.50 euro në vitin 2022. Këto grante janë përkrahur nga Zyra e BE në Kosovë përmes nismës së RrGK, "Ngritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OShC-ve: Avancimi i barazisë gjinore në mes të pandemisë COVID-19".



*RrGK mbajti Sesion Orientues me 27 përfitues të të FGK-së, mars 2022*

FGK ofron grante të vogla për OShCG-të që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit dhe të cilat përpiqen të punojnë për të drejtat e grave. Fondi përqendrohet në mbështetjen e grupeve që punojnë në zonat rurale dhe/ose me persona të margjinalizuar. Që nga viti 2012, FGK ka ndarë 252 grante, duke përkrahur kështu 149 organizata, në shumën e përgjithshme prej 1,477.067€. FGK ka pasur më shumë se 24,387 përfitues. Në vitin 2022, KWF mori mbështetje nga BE-ja,Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), Fondi i , Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) si dhe Sigrid Rausing Trust.

**Grantet e ndara nga FGK në 2022 përfshijnë:**

- Medica Kosova me nismën "Rritja e mirëqenies së fëmijëve/studentëve për një jetë pa dhunë" (9,998€).
- Handikos Mitrovica me nismën "Sfidat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara mes të COVID-19 në Komunën e Mitrovicës" (9,906€)
- Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar me nismën "Menaxhimi i situatës së pandemisë Covid-19 për të verbrit dhe të me të pamë të dobësuar" (9,562 €)
- Organizata Foleja me nismën "Ndikimi i Pandemisë COVID-19 te gratë dhe vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian" (9,989€)..
- Center for Education and Comunity Development Friends me nismën "Jeta pa dhunë në familje – promovimi i mekanizmave të mbrojtjes nga dhuna në familje" (9,351€).
- Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes me nismën "Përmirësimi i njohurive dhe fuqizimi i të rinjve për një jetë pa dhunë dhe ngacmime seksuale" (9,900€).
- Lëvizja YMCA me nismën "Promovimi i lëvizjes feministe përmes fuqizimit të vajzave dhe djemve" (9,868€).
- Lulishtja me nismën "Fuqizimi ekonomik i grave pas krizës së pandemisë COVID-19, përmes krijimit të vendeve të punës miqësore për familjen" (9,998€).

- Sundimi i Demokracisë në Kosovë (SDK) me nismën "Fuqizimi i mekanizmave për buxhetim të përgjegjshëm gjinor" (9,994€).
- Femrat Aktive të Gjakovës me nismën "Ofrimi i mbështetjes ligjore dhe psikologjike për gratë që janë viktima të dhunës në bazë gjinore" (9,975€).
- Instituti për Dialog dhe Mosdiskriminim me nismën "Trajtimi i problemeve psiko-sociale dhe ekonomike te gratë të shkaktuara nga pandemia COVID-19" (9,965€).
- Shoqata e Gruas Pensioniste "Vita Jeta" me nismën "COVID-19 dhe diabeti te të moshuarit" (9,794€).
- Bliri me nismën "Rritja e vetëdijes për shëndetin riprodhues te të rinjtë" (9,668€).
- Omladinski Centar Gracanica me nismën "Fuqizimi i vajzave me synim arritjen e pavarësimit ekonomik dhe pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse" (10,000€).
- Organizata Violeta me nismën "Vetëdijesimi i vajzave dhe grave në Komunën e Podujevës për një jetë pa dhunë me bazë gjinore" (9,980€).
- Zana me nismën "Fuqizimi ekonomik dhe politik i grave në Komunën e Klinës" (9,506€).
- You Can Do me nismën "Promovimi i mekanizmave shtetëror që gratë dhe vajzat me nevoja të veçanta të jetojnë pa abuzime seksuale" (9,978€).
- OJQ Rikotta me nismën "Parandalimi i dhunës përmes fuqizimit ekonomik të grave në Komunën e Prizrenit" (9,996.50€).

- Organizata për Hulumtim OMNES me nismën “Avokimi institucional për mbrojtje nga dhuna dhe trajtimi i ndikimit të pandemisë COVID-19 në stres dhe depresion te gratë” (9,802.50€).
- Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve Liria me nismën “Përfshirja e institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore me qasje të koordinuar ndaj dhunës ndaj grave dhe asaj në familje sipas Konventës së Stambollit” (9,565€)·
- Zenski Centar me nismën “Promovimi i të drejtave të viktimave të dhunës në familje përmes aktiviteteve digjitale dhe avokuese” (9,996€)·
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) me nismën “Strehim, rehabilitim dhe riintegrim për gra dhe fëmijë, viktima te dhunës ne familje” (9,993€)·
- Qendra për mirëqenien e gruas me nismën “Ofrimi i strehimit, mbështetjes ligjore dhe psikologjike për gratë e mbijetuara të dhunës” (9,996€).
- Shtëpia e sigurt Gjakovë me nismën “Fuqizimi psikosocial i grave që kanë përjetuar dhunë në familje dhe ngritja e vetëdijes se partnereve abuziv përmes këshillimit psikosocial” (10,000€).

QMGF “Raba Voca” me nismën “Ngritja e vetëdijes kundër dhunës ndaj grave” (9,993€).

Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve Prizren (QSGFP) me nismën “Ngritja e vetëdijes dhe fuqizimi i viktimave të dhunës në familje” (9,983€).

- Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, Shtëpia ime – Ferizaj me nismën “Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Regjionin e Ferizajt” (9,837€).

- Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore me nismën "Mbrojtja, avokimi dhe promovimi i të drejtave të viktimave dhe të viktimave potenciale të trafikimit me qenie njerëzore" (9,952€).

Ju lutemi shikoni Aneksin 1a për informacion të mëtejshëm në lidhje me grantet e përfunduara gjatë vitit 2022 si dhe rezultatet e tyre, dhe Aneksin 1b. për informacion në lidhje me grantet në vazhdim. Përveç kësaj, RrGK-ja gjithashtu siguroi financime për OSHC-të dhe veçanërisht për OShCG-të, përtej FGK-së.

## *Ngriten kapacitetet e stafit të RrGK*

RrGK ka vazhduar që të ofrojë mundësi për ngritje të kapaciteteve për stafin, duke përfshirë ato që ndërlidhen me komunikim ndërmjet zyrave, integrimin e perspektivës gjinore, sigurinë digjitale dhe financat. Monitorim i punës u ofrua në çështjet e lidhura me avokimin te BE; kryerjen e analizave gjinore, shkrimin e koncept-dokumenteve; hartimin e strategjive avokuese; hartimin e raporteve; monitorimin dhe vlerësimin; hulumtimin si dhe aftësitë e të shprehurit në publik. Më tej, RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave Avokate (EWLA) dhe me mbështetjen e BE-së, organizoi një punëtori për anëtaret e stafit, me temën: “Paga e barabartë”. Juristet nga EWLA diskutuan se sa e rëndësishme është që burrat dhe gratë të kenë pagë të barabartë për punën e njejtë. Për më tepër, gjatë vitit 2022 stafi i RrGK-së mori pjesë në trajnime të organizuara nga Kvinna till Kvinna, “Programi




*RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave Avokate (EWLA) mbajti dy punëtori, dhjetor 2022*

Ndërkombëtar i Trajnimit për Dhunën me Bazë Gjinore", përmes së cilit, u vizituan institucione të ndryshme në Suedi për të mësuar më shumë mbi trajtimin dhe referimin e dhunës me bazë gjinore. Përveç vizitës në Suedi, pjesa e dytë e këtij trajnimi u mbajt në Shqipëri me të njejtën tematikë dhe me të njejtat vizita. Gjatë 2022, stafi i RrGK-së gjithashtu vizitoi Austrinë dhe institucione të ndryshme për të shkëmbyer përvojat e trajtimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave.

## ***Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave***

Sado që disa iniciativa avokuese mund të ndërmerren në baza vullnetare, organizatat për të drejtat e grave (OShCG-të) ende kanë nevojë për burime për të përkrahur shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon mbështetje, andaj RrGK vazhdoi përpjekjet në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe në rajon. Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2022, RrGK është takuar me donatorë të ndryshëm për të avokuar lidhur me nevojat financiare të OSHCG-ve, kështu duke kontribuar në sigurimin e burimeve për OSHCG-të në Kosovë dhe rajon, siç dëshmohet nga fondet e dhëna nga FGK këtë vit.



*Materialet promovuese të RrGK-së me mesazhe feminist në dispozicion për donacion*

## ***Përmirësimi i zbatimit të Strategjisë së RrGK-së për Ngritje të Fondeve***

RrGK ka finalizuar Strategjinë për mobilizimin e resurseve, e cila identifikon mënyra të reja dhe alternative të mbledhjes së fondeve, përveç fondeve ndërkombëtare, të cilat mund të mbështesin RrGK-në dhe anëtaret e saj në planin afatgjatë. RrGK ka hulumtuar mundësi të ndryshme filantropie që ekzistojnë në të gjithë botën, veçanërisht në kontekste të ngjashme si Kosova. Rrjeti gjithashtu ka parë edhe ato mënyra që janë përdorur në Kosovë për të pasuruar Strategjinë. Më pas, RrGK ka vazhduar përpjekjet



RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS • KOSOVO WOMEN'S NETWORK • MREŽA ŽENA KOSOVA

për zbatimin e kësaj Strategjie. Kjo përfshinë edhe prezantimin e materialeve promovuese të RrGK-së të cilat përmbajnë mesazhe feministe, të qasshme në person ose online. Donacionet e pranuara për këta artikuj kontribuojnë në Fondin e Qëndrueshëm të RrGK-së, i cili ndihmon në mbulimin e shpenzimeve thelbësore dhe në mbështetjen e programeve të rëndësishme për barazinë gjinore. Sa u përket rezultateve, RrGK ka rritur kursimet në Fondin e saj të Qëndrueshmërisë nga 3,844 € në vitin 2019 në 15,804.91 € në vitin 2022. Këto përpjekje u mbështetën kryesisht nga BE-ja dhe Sida, si dhe nga Fondacioni Kvinna till Kvinna.

***Përmirësimi i njohurive dhe mirëkuptimit midis organeve përkatëse të BE-së dhe donatorëve të tjerë në lidhje me llojet e mbështetjes që u nevojiten OShCG-ve të ndryshme***

Përgjatë vitit 2022, RrGK kontribuoi në ngritjen e njohurimit dhe mirëkuptimit midis organeve përkatëse të BE-së dhe donatorëve, në lidhje me mbështetjen që u nevojitet OSHCG-ve të ndryshme, përmes 3 publikimeve në vijim, të cilat u ndanë me përfaqësues të BE-së në nivel ndërkombëtar dhe lokal:

- Komentar: Një lexim nga perspektiva Gjinore i Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën 2022;
- Gjinia dhe aftësia e Kufizuar në Legjislacionin e BE-së: Një Qasje Ndërthurëse drejt informimit të Kornizës Ligjore në Kosovë;
- Financimi i përgjegjshëm gjinor për shoqëruesit e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë;

Diku rreth 40 letra edhe emaile avokimi, i'u dërguan zyrtarëve të BE-së, për ti informuar për një perspektivë më të mirë më të mirë gjinore në procese të para-anëtarësimit në BE.

Gjatë Javës së Avokimit të BE-së të organizuar nga Kvinna till Kvinna, RrGK zgjeroi dhe përmirësoi njohuritë dhe të kuptuarit e organeve përkatëse të BE-së në lidhje me format e ndryshme të mbështetjes që kanë nevojë OshCG-të. Gjatë takimeve të ndryshme me zyrtarë të BE-së të përfshirë në procesin e bërjes së politikave për Financimin e Jashtëm të BE-së, RrGK ngriti nevojën për të rritur fondet e ndara për OShCG-të, dhe nevojën për financim të qëndrueshëm për Lëvizjen Feministe.

Ekspertët e RrGK-së kanë vazhduar të mbështesin Zyrën e BE-së në Kosovë, Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), Caritas Kosova dhe kontraktorët e tjerë fitimprurës dhe jofitimprurës që zbatojnë programet e zhvillimit në Kosovë, duke rekomanduar mundësi bashkëpunimi me (dhe mbështetje për) OShCG-të e cila do të kontribuonte në efektivitetin dhe qëllimet e tyre për zhvillim. Në disa raste, kjo përkthehet në kontraktorë që angazhojnë OShCG-të si partnerë dhe mbështesin punën e tyre. Gjatë vitit 2022, RrGK ka vazhduar te ofroj mbështetje drejt integrimit të perspektivës gjinore partnerëve të ADA's. Konkretisht, RrGK ka ndihmuar 3 partnerë të ADA's (QAINT, HERAS+, UNDP) që të përmirësojnë projektet e tyre që të mbrojnë dhe mbështesin edhe më tej interesat dhe të drejtat e grave dhe vajzave.

### ***Ndërgjegjësimi i përmirësuar institucional dhe publik mbi rëndësinë e zbritjes tatimore për të mbështetur punën e grupeve për të drejtat e grave***



RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS • KOSOVO WOMEN'S NETWORK • MREŽA ŽENA KOSOVA

Gjatë vitit 2021, RrGK dërgoi rekomandime për përmirësimin e sistemit tatimor, siç ishte rasti me Programin e Reformës Ekonomike dhe në lidhje me takimin e nën-komitetit për çështjet ekonomike, financiare dhe statistika të Marrëveshjes së Stabilizim Associmit (MSA). RrGK ka vazhduar bashkërendimin me organizatat tjera të shoqërisë civile për të përmirësuar kornizën ligjore dhe institucionale sa i përket filantropisë në Kosovë.

## Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është pjesëmarrja aktive e grave në politikë dhe vendimmarrje, në nivelin lokal dhe atë qendror. RrGK ka bërë progres drejt arritjes së këtij qëllimi, siç tregohet nga rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet me kalimin e kohës.

Pas zgjedhjeve parlamentare dhe lokale, RrGK ka punuar për rigjallërimin e Lobit për Barazi Gjinore dhe përfshirjen e grave këshilltare komunale të sapozgjedhura, deputeteve dhe gra të tjera të emëruara në pozita vendimmarrëse. Përgjatë muajve mars dhe prill, drejtorja ekzekutive e RrGK ka takuar nënrkeytaret e komunave të Gjilanit, Klinës, Podujevës dhe kryetaren e asamblesë komunale të Gjakovës. Qëllimi i këtyre takimeve ishte që të rritet solidariteti ndërmjet aktereve lokal që punojnë për të drejta të grave dhe rritja e pjesëmarrjes  efektive të grave në proceset vendimmarrëse.

Një indikator tjetër i pjesëmarrjes së përmirësuar të grave në politikë dhe vendimmarrje  janë politikat e ndryshuara, duke reflektuar më mirë prioritetet e grave në ligje dhe politika. Që nga fillimi i

numërimit RrGK, Lobi dhe anëtaret e Rrjetit kanë ndërmarrë gjithsej 557 iniciativa avokuese. Si rezultat, që nga viti 2016,, Rrjeti, anëtaret e saj si dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë arritur që suksesshëm të avokojnë për ndryshimin e 180 politikave për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave, në nivel lokal dhe qendror..

Në vitin 2022, gjashtë politika kanë përfshirë disa nga rekomandimet e RrGK-së, drejt pasqyrimit më të mirë të perspektivës gjinore, si dhe nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në politikëbërje:

1. Programi i Reformës Ekonomike 2022-2023
2. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2022
3. Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (2021-2025) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2023)
4. Strategji Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2022-2026
5. Strategjia për Sundim të Ligjit 2021-2026
6. Koncept Dokumenti për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor

Sa i përket buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, është rritur në 62 numri i organizatave buxhetore që kanë dorëzuar shtojcën me të dhëna në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, sipas Qarkoreve të Buxhetit. Këtë vit, 37 nga 38 organizata buxhetore të nivelit lokal (97%) kanë dorëzuar shtojcën e tyre si

pjesë e kërkesave buxhetore për vitin 2022. Ndërkohë, 45 nga 51 organizata buxhetore të nivelit qendror (88%) kanë dorëzuar shtojcën e tyre me buxhetore për vitin 2022. Ndonëse nuk është drejtpërdrejt rezultat i punës së RrGK, ne besojmë se RrGK dhe anëtaret e saj kanë kontribuar në këtë përmirësim në mënyrë indirekte përmes avokimit në nivel komunal dhe kombëtar. Më tej, kjo tregon për ndikimin afatgjatë të punës së mëparshme të RrGK-së me Ministrinë e Financave, së bashku me GIZ-in dhe USAID-in, përmes së cilës kërkesa për të përgatitur aneksin buxhetor të përgjegjshëm gjinor me kërkesat buxhetore vjetore u inkorporua në tekstin e qarkoreve buxhetore vjetore të Ministrisë..

Duke ditur se barazia gjinore është vlerë themelore e BE-së, RrGK gjithashtu monitoron procesin e anëtarësimit në BE nga perspektiva gjinore. Si rezultat i përpjekjeve të monitorimit dhe avokimit të RrGK-së, zyrtarët e Kosovës dhe të BE-së ndërmorën tetë veprime për të adresuar çështjet e ngritura nga gratë lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE:

1. Ata u konsultuan me RrGK-në në lidhje me Programin e Reformave në Ekonomi 2022-2023 dhe përmirësuan perspektivën gjinore brenda tij duke u bazuar në rekomandimet e RrGK-së;
2. Zyra e Kryeministrit publikoi Planin e Veprimit të ERA II, me rekomandimet e RrGK të përfshira në të dhe u zotuan të përfshijnë RrGK-në dhe OShCG-të në monitorimin dhe zbatimin e ERA II;
3. Zyra e BE-së në Kosovë ftoi OShCG-të për të kontribuar me rekomandime për Raportin e vitit 2022 të Komisionit Evropian për Kosovën;

4. Zyra e BE-së në Kosovë si dhe Drejtorati i Përgjithshëm i BE për Fqinjësi dhe Negocim të Zgjerimit organizuan takim konsultativ me RrGK për hartimin e Programit për Reforma në Ekonomi, të vitit 2022, për të futur perspektivën gjinore në këtë dokument.
5. Zyra e BE-së në Kosovë ka konsultuar OShCG-të para takimit me Qeverinë e Kosovës si pjesë e strukturave të MSA-së;
6. Qeveria e Kosovës konsultoi OShCG -të për rreth katër takime të MSA-së;
7. Raporti i Kosovës i Komisionit Evropian 2022 u publikua me rekomandime të RrGK dhe OShCG -ve dukshëm të integruara;
8. Zyrtarët e BE-së takuan OShCG -të në Bruksel, dhe u zotuan të vazhdojnë komunikimin në lidhje me cështjet të cilat grate i konsiderojnë prioritet;

## Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%)

Me mbështetje të BE-së dhe bashkëfinancim nga Sigrid Rausing Trust, RrGK ka vazhduar bashkëpunimin me Organizatën e Personave me Distrofi Muskulare dhe Ruka Ruci posaçërisht në drejtim të rritjes së angazhimit politik në procese vendimmarrëse të afërsisht 29 grave (katër gra me aftësi të kufizuara) dhe 36 grave serbe. Që nga viti 2019, RrGK ka rritur angazhimin politik të gjithsej 2,096 grave në proceset

vendimmarrëse, kjo gjithashtu edhe përmes FGK-së..Më pas,  në vitin 2022, 366 gra politikane dhe për t'u bërë politikane morën pjesë në trajnime dhe mentorim përmes iniciativave anëtareve të mbështetura nga FGK.

### *Koalicioni për Barazi funksional në nivelin lokal dhe qendror*

Koalicioni për Barazi u krijua në 22 qershor 2018. Ai përbëhet nga gratë në politikë në nivelin qendror dhe lokal, si dhe OShCG-të. Koalicioni mbështetë dhe fuqizon anëtaret për të përmirësuar pozitat e grave në politikë dhe vendimmarrje dhe për të promovuar avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Anëtaret e këtij Koalicioni janë zotuar se do të punojnë drejt përmbushjes së këtij misioni të përbashkët, pa marrë parasysh preferencat e tyre politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin socio-ekonomik. Në vitin 2022, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) së bashku me RrGK formuan Rrjetin Strategjik të Politikave Gjinore, të përbërë nga gra dhe burra përfaqësues të qeverisë, parti politike, shoqëritë civile dhe bizneset, të cilët së bashku do të adresojnë sfidat që pengojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të grave në proceset politike dhe avokojnë ndryshimet e nevojshme për të përshpejtuar barazinë gjinore në Kosovë.

### *Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore mbeti funksional*

Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore në Kosovë (këtu e tutje, Lobi) është themeluar në vitin 2014. Ai bashkon gratë politikane dhe gratë në shoqërinë civile për të avokuar në nivel lokal dhe qendror për avancimin drejt barazisë gjinore dhe ka vazhduar të funksionojë në 27 komuna. Sfidë e vazhdueshme për funksionimim e këtij grupi ka qenë situata politike dhe zgjedhjet e shpeshta që kanë ndikuar në ndryshimin e shpeshtë të anëtareve e që ka ngadalësuar punën e Lobit.

> *"Bashkë me RrGK-në do të përpiqemi që së bashku t'i përkrahim dhe fuqizojmë gratë në zgjedhje lokale. Sot, më shumë se asnjëherë gratë në politikë po përkrahim njëra-tjetrën dhe ne do ta shfrytëzojmë këtë moment"*
>
> Antigona Baxhaku – Idrizi, Drejtore, SHE Solutions

Numri i përgjithshëm i grave të angazhuara në Lob në vitin 2022 ishte 344. Së bashku, grupet e Lobit ndërmorën 19 iniciativa avokimi dhe kontribuan në shtatë ndryshime të politikave këtë vit. Më 16 maj, Lobi ka mbajtur mbledhjen e parë për të diskutuar "Sfidat me të cilat përballen nënkryetaret nëpër komuna". Përfaqësues të institucioneve, organizatave për të drejtat e grave, si dhe anëtare të RrGK e gra të angazhuara në politikë diskutuan dhe ndanë përvojat e tyre lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë në nivelin lokal. Gjatë këtij takimi u fol për arritjet, sfidat si dhe avokimet e nevojshme që duhet çuar përpara për të rritur përfaqësimin e grave në politikë dhe procese vendimmarrëse. Të pranishmet e vlerësuan këtë takim si mundësi të

domosdoshme për të arritur solidaritetin e nevojshëm ndërmjet akterëve që punojnë për të drejtat e grave dhe për rritjen e pjesëmarrjes efektive të tyre në procese vendimmarrëse.



*Mbahet mbledhja e Lobit për Barazi Gjinor, maj 2022*

Më 16 nëntor, Lobi u takua për të diskutuar "Gratë, paqja dhe siguria- Vendimmarrja në nivelin lokal." Anëtarët e Lobit dhanë sugjerime se si RrGK, përmes Strategjisë së saj të re, të kontribuojë në fuqizimin e grave dhe vajzave në nivel lokal dhe në vendimmarrje. Të Që nga fillimi i numërimit, 754 gra nga komuna të ndryshme në Kosovë kanë përfituar nga takimet e Lobit. Të dy takimet u mundësuan falë mbështetjes së BE-së, të bashkëfinancuar nga Sigrid Rausing Trust.

***Zhvillimi i kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave***

Takimi i lartpërmendur, e po ashtu edhe punëtoritë e mbajtura gjatë vitit, zhvilluan edhe më shumë kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira si dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre avokuese. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballe

Rogova, ka vazhduar të ofrojë seanca të mentorimit për anëtaret dhe grupet e Lobit nëpër Kosovë, përmes me shume se 1100 thirrjeve telefonike, e-mailit ose vizitave nëpër komuna. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtaret e Lobit në avokime për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. RrGK nuk i sheh apo trajton anëtaret e Lobit si anëtare të partive politike, por më shumë i sheh ato si udhëheqëse në komunat e tyre. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së gjithashtu promovoi nismat e tyre, mbështeti ato në avokim dhe i ndihmoi në tejkalimin e sfidave gjatë avokimeve të tyre drejt barazisë gjinore. RrGK informoi vazhdimisht gratë në politikë lidhur me procesin e anëtarësimit në BE dhe mundësitë e përfshirjes së tyre në këtë proces.

### ***Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e harmonizimit të LBGj me ligjet e tjera relevante***

RrGK, së bashku me shumë OSHC të tjera, ka avokuar për përmirësimin e integrimit gjinor dhe drejt harmonizimit të ligjeve në Kosovë me Ligjin për Barazi Gjinore. Në vitin 2022, RrGK avokoi për integrim më të mirë të perspektivës gjinore në ligjet dhe politikat e mëposhtme përmes ofrimit të kontributit specifik organeve përkatëse qeveritare: draft-Projektligji i Punës, draft Kodit Civil, draft-Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Draft-Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, draft-ligji për Banim Social, si dhe strategjite e planet e veprimit përcjellëse në këto fusha. RrGK vazhdoi të shtyjë përpara nevojën për hartimin e dispozitave të pushimit të lehonisë, atësisë dhe atij prindëror të Ligjit të ri të Punës në harmoni me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës si dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Rekomandimet lidhur me këtë çështje janë dërguar për të informuar takimet e komitetit të MSA-së..




*RrGK merr pjesë në aktivitetet gjatë Javës së Avokimit në Bruksel, nëntor 2022*

Së bashku me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Qendrën për Barazi dhe Liri (CEL), Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Sociale (CSGD) si dhe Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR-KS), RrGK ka avokuar fuqishëm për një draft më të ndjeshëm gjinor të Kodit Civil, ku do të merret parasysh gjendja e grave në Kosovë, veçanërisht lidhur me pronën dhe martesën.

RrGK vazhdimisht ka kërkuar harmonizimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Nacionale të cilët aktualisht kanë kuotën 30% për pjesëmarrjen e grave dhe burrave, me Ligjin për Barazinë Gjinore, i cili e definon barazinë si pjesëmarrje prej 50% të secilës gjini. Gjatë takimeve me Strukturat e MSA-së, kjo çështje u theksua si një nga rekomandimet kryesore që RrGK kishte për Raportin e KE-së për Kosovën. Po ashtu, gjatë javës së Avokimit të BE-së, të organizuar me mbështetjen e Kvinna till Kvinna, RrGK shtyu përpara nevojën për harmonizimin e këtyre ligjeve, duke folur drejtpërdrejt me përfaqësues nga shtetet anëtare të BE-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të BE-së për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR). Qysh nga viti 2019, , RrGK ka ndërmarrë rreth 30 iniciativa formale nëë lidhje me ndryshimin e këtyre ligjeve në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

### *Komunikim dhe bashkëpunim i shtuar mes grave në politikë, organizatave të grave dhe grave votuese për çështjet që ato i konsiderojnë prioritete*

Me mbështetjen e Koalicionit për Barazi, Lobit, RrGK-së dhe anëtareve të saj si dhe të grave në politikë, organizatat e drejtuara nga gratë, gratë votuese si dhe gratë në politikë arritën që të komunikojnë dhe të

bashkëpunojnë më shumë për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet. Për shembull, anëtaret e Lobit avokuan për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet në bashkëpunim të ngushtë me votuesit nga komunat e tyre. Këtë vit, Lobi mbajti 65 takime me gra politikane, votuese dhe OShC. Lista e iniciativave të tyre është në Shtojcën 2.

Përmes iniciativave të mbështetura nga FGK, anëtaret e RrGK, Partners Kosova, In time, Aureola, Centar Manjinske Zajednice, Moravski Biser dhe Era Fruit, mbajtën 62 takime ndërmjet grave në politikë, OShC-ve dhe votuesve.

Përveç kësaj, përmes mbështetjes nga RrGK, rreth 17 OShC kanë dërguar komentet e tyre në Zyrën e BE-së në Kosovë dhe KE-së për Raportin e KE-sëpër Kosovën për vitin 2022si dhe ofruan kontribut për takimin konsultativ të qeverisë me shoqërinë civile para takimit tëNën-komitetit të MSA-së për Drejtësi, Liri dhe Siguri.

Pesë organizata të mbështetura përmes iniciativës rajonale EQUAPRO e bashkëfinancuar nga BE dhe Sida "Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE" kanë ngritur cështje të përfaqësimit të grave në politikë, diskriminimit në punësim, buxhetimit të përgjegjshëm gjinore, dhe qasjes në drejtësi, në komunat e tyre përkatëse. Këto organizata ishin: Gruaja Hyjnore (Gjilan), Advocacy Center for Democratic Culture- ACDC (Mitrovicë e Veriut), Ecokos Women (Prishtinë), Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës – KGVK (Prishtinë) dheMinority Communities Center – MCC (Gracanicë).

RrGK lansoi botimin e dytë të librit *Fakte & Fabula për Rezolutën 1325* gjatë Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, të organizuar nga Presidentja e Kosovës, zonja Vjosa Osmani Sadriu. Libri përfshin "fakte", statistika, të dhëna, emra dhe "fabula": tregime se si njerëzit e perceptuan zbatimin e Rezolutës nga viti 2000 deri në 2020. Rrëfimet e librit e shëtisin lexuesin përmes shumë sfidave, sukseseve dhe fitoreve me të cilat u përballën aktivistet në luftën e tyre duke i bërë thirrje OKB-së, BE-së, NATO-s dhe zyrtarëve të Kosovës ta implementojnë Rezolutën 1325. Zyrtarët nga e gjithë bota morën informacione për këtë libër, të cilat ata mund t'i përdorin për të informuar punën e tyre në situata konflikti dhe pas konfliktit kudo, bazuar në mësimet e nxjerra nga Kosova.

Këto nisma të RrGK-së dhe anëtarëve të saj ilustrojnë mënyrat se si është rritur pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje.

### *Nisja e avokimeve për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet*

Më 21 shtator zyrën e RrGK-së e ka vizituar një delegacion i lartë i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) i udhëhequr nga zëvendësdrejtori Menaxhues i FMN-së, z. Bo LI. Drejtorja Ekzekutive Igballe Rogova dhe Menaxherja e Financave Besa Shehu informuan delegacionin e FMN-së për angazhimit e kahmotshëm të RrGK-së për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, sfidat me të cilat përballen vajzat dhe gratë dhe nevojën e fuqizimit të tyre politikisht dhe ekonomikisht.

Si pjesë e nismës së RrGK "Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë", mbështetur nga Zyra e BE në Kosovë me bashkëfinancim nga Sigrid Rausing Trust, RrGK së bashku me BE-në organizuan të marten

më 29 nëntor një drekë pune në mes të Ambasadorit Tomas Szunyog, Shef i Zyrës së BE-së / Përfaqësues i Posaçëm i BE-së në Kosovë, zyrtarëve të BE-së dhe grave lidere përfaqësuese të shoqërisë civile. Përgjatë dy orëve, gratë lidere patën hapësirën për të diskutuar e avokuar për çështje të ndryshme me rëndësi lidhur me dhunën me baza gjinore, fuqizimin ekonomik të grave, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, rëndësinë e mbështetjes së grave serbe në zonat rurale, sfidat e grave me aftësi të kufizuara dhe rëndësia e gjuhës së përbashkë për dialog nga pala Serbe dhe Kosovare për mirëqenien e qytetarëve, në pajtim me Rezoluten 1325, ndër të tjera.

Më 12 dhjetor, Drejtorja Ekzekutive e RrGK, Igballe Rogova, ka qenë e ftuar në takimin e të Dërguarit të Posaçëm të SHBA-së për Ballkanin Perëndimor Gabriel Escobar dhe Ambasadorit Amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier me disa përfaqësues të OShC-së. Ajo ngriti çështje të rëndësishme për gratë gjatë takimit.

Gjatë këtij viti dhe Strategjisë aktuale të RrGK-së, OSHCG-të u përfshinë më shumë në çështje dhe procese të ndryshme (duke përfshirë këtu edhe dialogun politik), veçanërisht përmes takimeve të nën-komisioneve të MSA-së dhe procesit të anëtarësimit në BE, ku ngritën çështje që ata i konsideronin prioritet. RrGK ka mbështetur dhe fuqizuar vazhdimisht gratë për të identifikuar dhe avokuar për prioritetet e tyre gjatë këtyre proceseve.

FGK gjithashtuka mbështetur përpjekjet e anëtareve të RrGK-së për të monitoruar dhe avokuar për zbatimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese. Këtë vit, FGK dhe Lobi ndërmorën 96 iniciativa avokuese për çështje që gratë i konsiderojnë prioritete.

## *Përmirësimi i institucionalizimi të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë*

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) siguron shpërndarje dhe shpenzimin e fondeve publike në mënyrë të barabartë, efikase dhe transparente të fondeve publike. Që nga viti 2011, RrGK ka punuar dhe avokuar drejt institucionalizimit të BPGj-së në Kosovë. Në vitin 2022, kjo punë u mbështet nga ADA me bashkëfinancim nga Sida

Në vitin 2021, RrGK ka mentoruar gjashtë organizata gjatë zbatimit të nismave të tyre në lidhje me BPGj në Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë, Gjakovë, Mitrovicë Veriore dhe Viti. Këto organizata përfshijnë: Organizata për Reforma Lokale (EULOC), Undruženje Poslovnih Žena (WBA), Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR), Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YAHR), Iniciativa e Gruas Kosovare si dhe EcoKosWomen. Fillimisht, ato kanë qenë pjesë e tre trajnimeve të mbajtura për rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre mbi BPGj-në si pjesë e nismës rajonale të Rrjetit të Mbikëqyrësve të Buxhetit Gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë, mbështetur nga ADA. Respektivisht, nismat e tyre janë si vijon: "Monitorimi dhe mentorimi i zbatimit të duhur të politikave gjinore në Komunën e Vitisë"; "Fuqizimi i grave përmes analizës së politikave lokale dhe pjesëmarrjes në

buxhetimin gjinor në veri të Kosovës"; "Perspektiva gjinore për planifikim të qëndrueshëm ekonomik"; "Monitorimi dhe analizimi i politikbërjes në nivel lokal nga perspektiva gjinore"; "Buxhetimi gjinor drejt zhvillimit ekonomik të balancuar gjinor"; dhe "Menaxhimi i higjienës menstruale, jetë e pastër për gratë dhe vajzat".Ato kanë punuar me grupe të synuara të ndryshme në Kosovë, por kryesisht me Drejtoritë e Buxhetit dhe Financave në komunat e tyre, si dhe me drejtoritë dhe institucionet e tjera komunale. Me njohuritë e marra mbi BPGj-në gjatë trajnimeve si dhe me mbështetjen e RrGK-së gjatë këtij viti, ata kanë arritur tek rreth 3600 përfitues direkt dhe indirekt me shumë informacion në lidhje me BPGJ dhe zbatimin e tij.

Ndërkohë, RrGK ka vazhduar të avokojë për zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara (OKB) Treguesi 5.c.1, sipas angazhimeve të Kosovës për zbatimin e SDG-ve dhe BPGj-së; si dhe për rekomandimet e paraqitura në Analizën Gjinore Fiskale të Buxhetit nga RrGK *"Pandemia nuk njeh gjini?".* Është e rëndësishme të theksohet se Pako e Ringjalljes Ekonomike, e bërë publike në qershor, përfshin katër masa pozitive gjinore, që është më shumë se pakot e mëparshme të hartuara ndaj pandemisë COVID-19.

Rekomandimet për buxhetim më të përgjegjshëm gjinor në nivel komunal u ndanë me anëtaret e RrGK-së gjatë dëgjimeve publike për ndarjet buxhetore për vitin 2023. Anëtaret e RrGK shprehën shqetësimet dhe rekomandimet e përbashkëta për përfaqësuesit e tyre përkatës komunal. RrGK dhe anëtarët e saj gjithashtu vazhduan të rrisin pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në në dëgjime publike me disa organizata anëtare në Vushtrri, Viti, Ferizaj, Novobërdë, Skenderaj, Drenas, Gjakovë, Mitrovicë, Kllokot dhe Istog. Përgjatë muajit shtator, dhjetë organizata anëtare kanë organizuar mbi 25 takime. Këto takime

mblodhën së bashku rreth 300 gra dhe vajza të cilat diskutuan nevojat dhe prioritetet e tyre të ndryshme dhe se si këto mund të reflektohen në ndarjet buxhetore komunale për vitin 2023. Tutje, janë organizuar mbi 15 takime me zyrtarë komunal për të adresuar rekomandimet e dala nga takimet që përfashijnë: financim më të mirë në disa linja buxhetit komunal për barazinë gjinore, fuqizimin ekonomik të grave, adresimin e dhunës me bazë gjinore, edukimin cilësor të barabartë dhe kujdesin shëndetësor. RrGK ka vazhduar të avokojë për rëndësinë e ndarjeve buxhetore  duke adresuar nevojat dhe prioritetet e ndryshme që gratë dhe burrat kanë.

Për më tepër, në muajin nëntor, RrGK së bashku me UN Women u kanë dërguar letër secilit deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës me.10 rekomandime konkrete lidhur me institucionalizimin e BPGj-së dhe përfshirjen e tij në buxhetin për vitin 2023.

## Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OSHCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE

RrGK ka kontribuar rregullisht në përfshirjen e organizatave anëtare dhe të grave politikane në procesin e anëtarësimit në BE. Aktivistët dhe organizatat për të drejtat e grave u inkurajuan dhe u ndihmuan për të dhënë kontribut në Raportin e KE për Kosovën të këtij viti.Tutje, 75% e këtyre rekomandimeve janë pasqyruar në raportin e vitit 2022, i cili ka vazhduar të ketë perspektivë më të mirë gjinore dhe të jetë më gjithpërfshirës në sektorë të ndryshëm. Për më tepër, rreth70 % të komenteve të RrGK ishin të integruara në Programin e Reformave në Ekonomi.

Përgjithësisht, në 3 vitet e fundit, perspektiva gjinore në dokumentet e anëtarësimit në BE është rritur dukshëm. Në vitin 2020, rreth 50% e të sugjerimeve të RrGK-së dhe anëtarëve të saj  u pranuan sa i përket integrimit më të mirë gjinor të këtyre dokumenteve, ndërsa në vitin 2022 u adresuan 80% e komenteve tona.. RrGK gjithashtu ndihmoi shumë OShCG, në Kosovë dhe BP, për të përgatitur rekomandime që do të informonin procesin e anëtarësimit në BE dhe takimet e strukturave të MSA-së.. Më saktësisht, RrGK,së bashku me OShC-të tjera ndërmorri nismat e përbashkëta avokuese të renditura më poshtë:

- Përfshiu më shumë OShCG-të të ndryshme në më shumë, çështje dhe procese të ndryshme (dialogët politikë), veçanërisht përmes takimeve të strukturave të MSA-së.
- Konsultoi OShCG-të për të marrë kontributin e tyre në lidhje me Raportin e KE për Kosovën, të vitit 2022.
- Kontriboi me rekomandime konkrete për Programin e Reformave në Ekonomi 2022-2024, në kuadër të platformës për konsultime publike.
- U dërgoi rekomandimet e dhëna për ARE II zyrtarëve të zyrës së BE-së në Kosovë.
- Komentoi në draft-Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave dhe dhuna në Familje, veçanërisht në drejtim të harmonizimit të plotë të këtij-draft ligji me konventën e Stambollit.
- Dërgoi komente në lidhje me draft-ligjin për Banim Social, në drejtim të sigurimit të masave afirmative për gratë e mbijetuara të dhunës.

- Avokoi vazhdimisht që drafti i Kodit Civil të përafrohet me Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore dhe praktikat më të mira, duke përfshirë sigurimin e të dhënave/kontributin për dispozitat që rrezikojnë të drejtat e grave, për, të drejtën në martesë, dhe për të ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi në bazë te seksit apo gjinisë.
- Mori pjesë në gjashtë takime konsultative, në kuadër të strukturave të MSA-së: MSA NK – Takimi mbi Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë (dy takime të ndara, me BE-në dhe me qeverinë); MSA NK – Takimi mbi Transportin, Ambientin, Energjinë dhe Zhvillimin Regjional; MSA NK – Takimi mbi Shoqërinë e Informacionit, Politikat Sociale dhe Edukimin.
- Konsultoi anëtaret për çështjet që duhej ngritur në javën e avokimit të Kvinna till Kvinna, të organizuar nga BE 2022 duke ndarë rekomandimet e tyre me disa zyrtarë të BE-së.
- Ndërmori avokimin e përbashkët në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në kuadër të implementimit të Planit të Veprimit të ERA II, sidomos në lidhje me Reformën e Administratës Publike.
- Komentoi në Raportin e Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut për vitin 2022.
- Ndërmori avokimin e përbashkët në nivel rajonal me Olga Martin Gonzalez, Këshilltaren Gjinore në Bruksel dhe me personat (pikët) gjinore në kuadër të delegacioneve të BE në Ballkanin Perëndimor, takim ky i cili u organizua me mbështetjen e Kvinna Till Kvinna, për perspektivë më të mirë gjinore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.

- Mori pjesë në takimin e përbashkët e OshCG-veme Komisioneren e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut për të diskutuar mbi përfaqësimin më të denjë të grave në politikë dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore, poashtu diskriminimit me bazë gjinore.
- Mori pjesë në avokimin e  përbashkët e OshCG-ve në kuadër të grupit punues për barazi gjinore, të themeluar me iniciativë të zyres së presidentes, përkatësisht, nga Këshilli për Demokraci dhe të drejta të Njeriut.

Nismat drejt përmirësimit dhe rritjes së pjesëmarrjes së OShCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE në Kosovë u bashkëfinancuan nga BE-ja dhe Sida, si dhe u mbështetën nga Fondacioni Kvinna till Kvinna.

### *OSHCG-të dhe gratë janë më të informuara rreth proceseve të anëtarësimit në BE, rolin e tyre dhe si të angazhohen*

Rreth 19 OShCG, anëtare apo partnere të RrGK morën pjesë direkt në avokim në proceset që ndërlidheshin me anëtarësimin e Kosovës në BE, nën udhëzimet e vazhdueshme të stafit të RrGK-së. Ky numër është rritur nga 7 organizata në 2020.

Për sa i përket ngritjes së kapaciteteve, në Mars 2022, RrGK mbajti punëtori në lidhje me informimin e organizatave anëtare mbi strukturat ekzistuese të BE në Kosovë tek të cilat mund të avokohet drejt avancimit të barazise gjinore, përfshirë mbi oraret e konsultimit, dokumentet të cilat zakonisht duhet të përcillen, agjendat përkatëse dhe informata të tjera. Kjo punëtori u shfrytëzua poashtu për ngritjen e

vetëdijes së rreth 19 organizatave të ndryshme pjesëmarrëse në lidhje me kontributin të cilin ato mund të ofrojnë për konsolidimin e përvitshëm të inputit për Raportin e Komisionit Evropian për vendin.
Organizatat pjesëmarrëse përfshinin katër nga anëtarët e lartpërmendur të RrGK të cilat janë duke implementuar aktualisht projekte të tyre në kuadër të nismës së koalicionit rajonal EQUAPRO "Avancimi i Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE" imbështetur nga BE-ja dhe Sida. Pas kësaj, morën pjesë aktivisht në konsultimet e organizuara nga zyra e BE-së në Kosovë dhe nga qeveria e Kosovës, të nën-komiteteve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

RrGK së bashku me EWLA kanë organizuar punëtori mbi "Kornizën ligjore të BE-së për barazi gjinore ". Juristet nga EWLA, Katharine Miller dhe Sylvia Cleff Le Divellec kanë shpjeguar para anëtareve të RrGK-së dhe Lobit për Barazi Gjinore instrumentet kryesore ligjore të BE-së lidhur me barazinë gjinore. Anëtaret e RrGK shkëmbyen përvoja dhe diskutuan strategjitë e avokimit për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.. Zyrtaret komunale ngritën çështjen e zbatimit të politikave dhe reformave të BE-së në nivel lokal.

RrGK dhe EWLA organizuan punëtorinë "Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë nga perspektiva gjinore". Organizatat anëtare të RrGK-së diskutuan për aspektin praktik e ligjor të zbatimit të të drejtave të grave me aftësi të kufizuara, si dhe mundësitë për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Katharina Miller dhe Sylvia Cleff Le Divellec diskutuan mbi diskriminimin në vendet e tyre si dhe mbi atë se çka duhet bërë që të luftohen pabarazitë e shumta gjinore në rrethanat e Kosovës.

Që nga viti 2019, RrGK së bashku me EWLA të mbështetur nga BE-ja, Sida dhe Sigrid Rausing Trust, kanë trajnuar rreth 95 gra aktiviste dhe politikane lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE.

### *Përmirësimi i njohurive dhe të kuptuarit e palëve të interesit në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE*

Në vitin 2022, RrGK vazhdoi avokimin drejt avancimit të njohurive dhe kuptimit të palëve të interesuara për rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE. Kjo u arrit përmes letrave e takimeve avokuese, dhe rekomandimve përmes procesit të konsultimit publik mbi politikat e shumta publike. RrGK gjithashtu angazhoi OShCG-të në përfshirjen gjinore të Planit të Veprimit ARE II, Raportin e Progresit për vitin 2022 dhe në rekomandimet ne mbi gjashtë takime të ndryshme të MSA-së.

> *"Hulumtimet e juaja janë tejet të vyeshme për punën tonë në integrimin e perspektivës gjinore në procesin e Sundimit të Ligjit. Ju inkurajojmë të vazhdoni të na informoni dhe të na i dërgoni ato, sic keni bërë deri më tani, sepse ndihmojnë shumë" –*
>
> Vivien Savoy – Zyrtar i KE për Sundim të Ligjit

Përgjatë javës së avokimit, të organizuar nga Kvinna till Kvinna, RrGK, bashkë me anëtaret e saj, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) dhe Asociacioni i Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR) morrën pjesë në këto takime:

- Chloe Laurens Dinsdale, Koordinatoren për Barazi në kuadër të Drejtorisë se Përgjithshme për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) dhe Irene Ceccanti, Eksperte Gjinore, ku u diskutua për procesin e integrimit të perspektivës gjinore në Raportin e Komisionit Evropian;
- Lina Andeer, Këshilltare për Barazi Gjinore, Paqe dhe Siguri në kuadër të "Civilian Planning Conduct Capability (CPCC) dhe Stella Rhoner Grubacic, Këshilltare e Sekretarit të Përgjithshëm për Gjini dhe Diversitet, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian (EEAS)- ku OShCG-të avokuan për përfshirjen e grave në procesin e paqes;
- Ema Asciutti, Menaxhere e Programit për Gjini dhe Përfshirje Gjinore në kuadër të Drejtorisë se Përgjithshme për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) dhe Marie Sofie Sveidqvist, ku OShCG-të avokuan për financim më të mirë të lëvizjeve të grave;
- Viola Von Cramonn dhe asistenti i saj, Djorde Bojovic, të cilët u zotuan për përfshirje më substanciale të OShCG-ve lokale në vizitat e tyre në Kosovë, për t'i konsultuar ato sidomos në lidhje me proceset paqe-bërëse; dhe
- Vivien Savoye, Zyrtar i KE për Sundim të Ligjit, për Kosovën dhe Giulio Crespi – Asistent i politikave dhe Personakryesor për çështje gjinore, në Komisionin Evropian, me të cilët u diskutua situata e dhunës me bazë gjinore ndaj grave në Kosovë, diskriminimi me bazë gjinore, situata e personave me aftësi të kufizuara – me theks gratë me aftësi të kufizuar dhe gjuha e përdorur në lidhje me barazinë gjinore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. RrGK poashtu u

prezantoi zyrtarëve të BE-së edhe Komentarin e përgatitur në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2022.

RrGK gjithashtu kontriboi në përmirësimin e njohurive dhe të kuptuarit e palëve të interesit në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE, edhe në takimet me zyrtarët në vijim:

1. Vedat Sagonjeva, Zyrtar për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit;
2. Erëza Pula, (Ish) Pikë Fokale Gjinore në Zyrën e BE-së në Kosovë;
3. Besnik Bislimi, Zv. Kryeministër i Kosovës
4. Jeton Karaqica, Drejtor i Zyrës për Kritere Ekonomike dhe Treg të Brendshëm, Zyra e Kryemkinistrit;
5. Agim Kukaj, Drejtor i Departamentit të Postës dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë;
6. Tomas Szunyog, Shef i Zyrës së BE-së dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë ;
7. Naim Qelaj, Avokati i Popullit;
8. Edi Gusia, Kryeshefe e Agjencionit për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit;
9. Habit Hajredini, Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit.

Përgjatë viteve 2019-2022, RrGK, e mbështetur nga BE-ja, Sida dhe Kvinna till Kvinna, ka ngritur vetëdijen e më shumë se 250palëve të interesit, të përfshira në integrimin e perspektivës gjinore në procese të anëtarësimit në BE.

## Përmirësimi i integrimit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre

RrGK vazhdoi angazhimin mbi perspektivën gjinore në dokumentet publike në nivel qendror, si dhe lidhur me procesin e Anëtarësimit në BE, përfshirë nivelin ndërkombëtar. Këtë vit, RrGK ka komentuar gjithsej në 10 politika:

1. Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030
2. Raporti i Kosovës për vitin 2022 (së bashku me organizatat anëtare)
3. Draft Agjenda Digjitale 2030
4. Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023
5. Draft Ligji mbi Shërbimet Sociale Familjare
6. Draft Ligji për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave
7. Draft Ligji mbi Financat e Qeverisjes Lokale
8. Draft Rregullorja mbi Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publik.
9. Draft Ligji për Ndarjen Buxhetore për vitin 2023
10. Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2022-2026.

Sa i përket rezultateve, komentet e RrGK ishin 75% të integruara në Raportin e Kosovës së Komisionit Evropian për vitin 2022 dhe 70% në Programin e Reformave në Ekonomi 2021-2023. Kjo shkallë e pranimit të komenteve të RrGK-së nga EUpër dokumentet që kanë të bëjnë me anëtarësimin në BE është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme (50% në 2019, 55% në 2020, 70% dhe 2021).Këto përpjekje u mbështetën nga BE-ja, Sida dhe Kvinna till Kvinna.

***Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarëve të BE-së, Zyrës së Kryeministrit - Strukturave të Integrimit Evropian, Mekanizmave Kombëtar për Barazi Gjinore si dhe ministrive të linjës lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet relevante për anëtarësimin në BE***

RrGK ka vazhduar ofrimin e ndihmës teknike për BE-në në Kosovë në lidhje me proceset e integrimit të çështjeve gjinore, dokumentet e veprimit, kontratat dhe dokumentet tjera përkatëse. RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e saj me strukturat e Ministrisë së Integrimit Evropian, të shkrira në Zyrën e Kryeministrit. Njohuritë e tyre mbi integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e anëtarësimit në BE janë përmirësuar si rezultat i këtij bashkëpunimi, përfshirë edhe procesin e konsultimit publik. Dokumentet e anëtarësimit në BE tregojnë përmirësim të dukshëm në masën në të cilën ato i kanë integruar çështjet gjinore, megjithëse nevojiten përpjekje të mëtejme për të zbatuar zotimet. Gjatë vitit 2022, RrGK ka mentoruar 48 zyrtarë të zyrës së BE-së në Kosovë lidhur me tema të ndryshme mbi analizën gjinore, PVGj III,

integrimin e perspektivës gjinore dhe të tjera. Gjatë kësaj periudhe RrGK ka mbajtur 93 sesione mentoruese për zyrtarët e BE-së, duke çuar në total prej 273 sesioneve mentoruese që nga viti 2015.

Në vitin 2022, RrGK organizoi katër trajnime me kërkesë të Zyrës së BE-së në Kosovë për stafin dhe zyrtarët e saj, duke përfshirë dy trajnime bazë për barazinë gjinore (të detyrueshme për të gjithë stafin), një trajnim për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe një trajnim për çështjet gjinore në drejtësi dhe sundim të ligjit.

Gjatë një prej takimeve të rregullta me Shoqërinë Civile në lidhje me implementimin e Agjendës për Reforma Evropiane – Planin e saj të Veprimit, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, falënderoi veçanërisht RrGK-në për kontributin e dhënë në integrimin e perspektivës gjinore në procesin i anëtarësimit në BE, dhe tregoi përkushtimin që të konsultohet me RrGK për shënjimin e OShCG-ve në nivel lokal, të cilat mund të kontribuojnë, për një proces më të mirë dhe më gjithëpërfshirës të konsultimit të shoqërisë civile.

RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), si mekanizmi kryesor i barazisë gjinore në Kosovë. RrGK vazhdimisht ka përditësuar ABGJ-në rreth iniciativave dhe avokimit në lidhje me përfshirjen e barazisë gjinore në procesin e para-anëtarësimit në BE. Gjithashtu, për sa i përket punës së RrGK-së, RrGK u konsultua dhe bashkëpunoi me mekanizmat e barazisë gjinore në komuna dhe ministri.

***Përmirësimi i aftësisë së komisioneve të ndryshme, sidomos komisionit për integrimin në BE, dhe OShCG-ve, për të monitoruar zbatimin nga perspektiva gjinore***

RrGK nuk punoi me komisionet parlamentare ashtu siç ishte planifikuar për shkak të kohës së pamjaftueshme mes të çështjeve të tjera të ngutshme

## Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II dhe III

Në vitet e kaluara, RrGK ka raportuar për zbatimin e PVGj II, i cili ka përfunduar. Në vitin 2022, RrGK ka vazhduar të avokojë dhe të mbështesë zbatimin e përmirësuar të PVGJ III të BE-së, siç ilustrohet nga rezultatet e mëposhtme.

***Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve të BE-së lidhur me nevojën për angazhim më të fuqishëm politik, buxhet të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGj III.***

RrGK ka monitoruar zbatimin e Planit e Veprimit Gjinor në Nivel Vendi (CLIP), si dhe prodhoi një dokument që monitoronte punën e BE-së drejt avancimit të barazisë gjinore, e cila përfshinte vëmendjen për zbatimin e PVGJ-së III. RrGK i prezantoi gjetjet Zyrës së BE-së në Kosovë dhe zyrtarëve të BE-së në Bruksel gjatë Javës së Avokimit në Nëntor të vitit 2022Gjatë ofrimit të mbështetjes teknike për Zyrën e BE-së në Kosovë, RrGK gjithashtu vazhdoi të diskutojë rregullisht zbatimin e PVGj III me zyrtarët. Në përgjithësi, që kur RrGK filloi numërimin në vitin 2020, RrGK ka mbajtur më shumë se 38 takime me zyrtarët përkatës të BE-së gjatë të cilave u diskutua për zbatimin e PVGj II dhe III.

***Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve përkatës lidhur me reformat që kërkohen për dokumentet dhe shabllonet, drejt përmirësimit të zbatimit të PVGj III***

RrGK ka vazhduar të mbështesë Zyrën e BE-së në Kosovë në përdorimin e listave kontrolluese për të përmirësuar integrimin e perspektivës gjinore në programe, në përputhje me Markerin e Politikave për Barazi Gjinore. RrGK gjithashtu ka vazhduar të nxjerrë rekomandime për KE-në për përmirësimin e shabllloneve të saj.

***Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të personelit të BE-së dhe ShA-ve lidhur me PVGj II dhe zbatimin e tij***

..RrGK vazhdoi të punojë ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë drejt zbatimit të PVGj III. RrGK ofroi ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë mentorimin dhe trajnimin për tema të ndryshme që lidhen me PVGj III.Përmes kësaj, RrGK ka kontribuar në zbatimin e PVGj II dhe CLIP-ve, hartimin e të cilave e ka mbështetur në vitin 2021.

Në lidhje me zbatimin e PVGj III, veçanërisht objektivin që 85% e të gjitha veprimeve të financuara nga BE-ja të kenë Marker Gjinor 1 ose 2,RrGK ka vazhduar të mbështesë integrimin e perspektivës gjinore në Dokmente të Veprimit (Action Documents) të BE-së. Në total, RrGK ka shqyrtuar dhe përmirësuar 38 dokumente gjatë vitit 2022, duke cuar në 74 numrin total të

dokumenteve të përmirësuara që nga viti 2020. Me mbështetjen e RrGK-së, përqindja e kontratave të shënuara me Marker Gjinor 1 ose 2 është rritur për gati 20% që nga viti 2018.2.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh se Austria është shtet anëtar i BE-së, RrGK vazhdoi të mbështesë partnerët e ADA-së në përfshirjen e perspektivës gjinore në veprimet e tyre në përputhje me zotimet në PVGj III të BE-së.

***Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit në radhët e OShCG-ve dhe MKBGj-ve lidhur me PVGj-në dhe mënyrën se si të përkrahet zbatimi i tij***

Në mars 2022, RrGK mbajti një punëtori me anëtare të RrGK dhe organizata partnere, në lidhje me avokimin në kuadër të Strukturave të BE në Kosovë dhe mekanizmave të MSA-së. Sic është theksuar, rreth 19 OShCG ishin prezentë. Ndër temat e diskutuara ishtepërgjegjësia e zyres së BE në Kosovë për të implementuar PVGj III edhe atë në nivel vendi (përmes CLIP), i cili përfshin konsultimin e OShCG-ve. RrGK gjithashtu ngriti ndërgjegjësimin e OShCG -ve për PVGj III gjatëtakimeve planifikuese për t'u përgatitur për Javën e Avokimit në BE, takimin avokues me Ambasadorin e BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog dhe gjatë takimit planifikues me organizata partnere në nivel rajonal, për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e Berlinit.

Tutje, kur komentonte politikat publike, RrGK iu referua PVGj III në komente, duke ia kujtuar Qeverisë, përfshirë Mekanizmat Kombëtarë për Barazi Gjinore (MKBGJ). Kjo kontribuoi në ngritjen e vetëdijes së tyre për PVGJ III dhe zotimet e tij.

**Përmirësimi i hartimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II**

Në vitet e mëparshme, RrGK dha komente dhe avokoi për përmirësime të PVGj III bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II. Disa nga rekomandimet e RrGK-së janë marrë parasysh, siç shpjegohet në Raportin Vjetor të RrGK-së për vitin 2021. Përkundër disa përmirësimeve në PVGj III, disa nga rekomandimet e RrGK-së nuk u miratuan dhe avokimi i mëtejshëm mund të vazhdohet në lidhje me rishikimin afatmesëm të PVGj III dhe PVGj IV të mundshëm.

***Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit lidhur me përmirësimet e nevojshme në PVGj III***

PVGj III ka treguar përmirësime të konsiderueshme dhe ka inkorporuar shumë rekomandime të cilat RrGK ua ka përcjellë zyrtarëve relevantë të BE-së, të cilat janë cekur edhe në përmbledhjen e politikave "Duke ndjekur BE-në. Angazhimet për Barazinë Gjinore: Mësimet e nxjerra nga PVGj II për të informuar PVGj III". RrGK gjithashtu po kërkonte në mënyrë aktive harmonizimin e Rregullores së BE-së për Instrumentin e Para-Anëtarësimit me PVGj III, dhe rregullorja e publikuar gjithashtu ka marrë parasysh disa nga rekomandimet që janë përfshirë në dokument. Këto ndryshime rrisin vetëdijen lidhur me përmirësimet e nevojshme për PVGj III

**Përmirësimi i transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës**

RrGK vazhdimisht monitoron transpozimin e Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës, si një nga kushtet kryesore për avancimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE. Siç u përmend, RrGK ka komentuar në disa dokumente thelbësore të lidhura me anëtarësimin në BE, duke sugjeruar transpozim më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore, në veçanti të direktivave të BE-së për të drejtat e grave, shtatzëninë dhe barazisë gjinore, me fokus në direktivën e BE-së për ekuilibrin punë-jetë. Megjithëse këto rekomandime janë pasqyruar dhe përfshirë në disa politika, ka ende mungesë të zbatimit dhe të miratimit të draft-ligjeve kryesore të cilat do të prekin jetërat dhe mirëqenien e grave në Kosovë (draft-Ligji për Shërbime Sociale Familjare, draft-Ligji për Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave, draft-ligji për Banim Social). RrGK do të vazhdojë të monitorojë dhe avokojë për zbatimin e tyre si dhe traspozimin e Acquis mbi Barazinë Gjinore në Ligjet dhe politikat e Kosovës. Këto përpjekje janë mbështetur nga BE-ja, Sida dhe Kvinna till Kvinna

***ABGj, ZKM- Strukturat e Integrimeve Evropiane dhe MFPT të informohen më mirë në lidhje me nevojat për përmirësimin e transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës***

Kur komentoi ligjet e lartpërmendura, RrGK informoi këto palë kryesore të interesuara të qeverisë për komentet e dhëna. Zyra e Departamentit të Integrimeve Evropiane në kuadër të zyrës së Kryeministrit u informua vazhdimisht për nevojat e transpozimit gjatë bashkëpunimit për hartimin e ERA-s, PKZMSA-së dhe në takimet konsultative të MSA-së. RrGK u takua me Strukturat e Integrimeve Evropiane në Zyrën e Kryeministrit përafërsisht 15 herë vetëm gjatë vitit 2022.

***Ekzistojnë përmbledhjet e shkruara të politikave për Ligjin e Punës, Ligjin për Shërbimin Civil, Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi***

Gjatë zbatimit të Strategjisë aktuale të RrGK-së, RrGK ka dërguar letra avokuese në lidhje me Ligjin e punës, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për gjidhënie dhe Ligjin për Mbrojtje nga diskriminimi, në kuadër të:

a) Inputit të dërguar tek qeveria e Kosovës dhe zyra e BE-së në Kosovë, në konsultimet e mbajtura para takimit të Nën-komiteti për Shoqëri të Informacionit, Politika Sociale, dhe Edukim;
b) Komentarit të përpiluar, për Raportin e KE për Kosovën, të vitit 2022;
c) Inputit të dërguar për Programin e Reformave në Ekonomi 2023-2025 dhe
d) Inputit të dërguar për Draft-Strategjinë Kombëtare për Zhvillim.

# Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor

## Rritet llogaridhënia e zyrtarëve publik dhe institucioneve shëndetësore në adresimin e shkeljeve të të drejtave të grave në kujdesin shëndetësor

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është t'u sigurojë grave qasje në kujdes shëndetësor cilësor të përballueshëm. Përderisa shëndeti riprodhues i grave duket se është në qendër të shumicës së aktiviteteve për zhvillim, RrGK e konsideron shëndetin e përgjithshëm të grave po aq të rëndësishëm. Gjersa burimet për punën në lidhje me përmirësimin e qasjes së grave në kujdesin shëndetësor cilësor mbeten të

kufizuara, njëfarë progresi është duke u bërë drejt këtij objektivi, falë punës së anëtareve të RrGK-së, të mbështetur nga RrGK.

### *Kapacitetet e përmirësuara të grupeve për të drejtat e grave për të dokumentuar shkeljen e të drejatave të grave në kujdesin shëndetësor*

Mbështetur nga FGK pesë përfaqësues/e të organizatave anëtare të RrGK, janë më të informuar rreth dokumentimit të shkeljeve të drejtave të grave në kujdesin shëndetësor pas ndjekjes së një trajnimi profesional. Duke filluar nga viti 2023 dhe duke përdorur këtë njohuri, organizatat do të monitorojnë dhe dokumentojnë shkelje të tilla të të drejtave me mbështetjen e FGK. Këto iniciativa financohen nga ADA.

### Rritja e qasjes së grave në kujdes shëndetësor

Me mbështetjen organizative të ofruar nga Sigrid Rausing Trust, përmes FGK, Aleanca e Grave për Integrim, anëtare e RrGK organizoi ligjerata për të rritur ndërgjegjësimin e grave rome, ashkalike dhe egjiptiane për të drejtat e tyre në shëndetin mendor, drejt përmirësimit të shëndetit mendor, veçanërisht për çështjet që lidhen me diskriminimin ndërthurës.Organizata anëtare e RrGK-së,, Handikos Mitrovica, gjithashtu ka mbështetur 23 gra që të kenë qasje në kujdesin shëndetësor, në vitin 2022r. Ndërsa që kur ka filluar numërimin 4,368 gra dhe vajza kanë qasje në kujdesin shëndetësor cilësor përmes iniciativave të anëtareve të RrGK mbështetur nga FGK.

***Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtën e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre***

Të mbështetura nga FGK përmes iniciativave të saj, anëtaret e RrGK Handikos Mitrovica, OJQ ATO, Partners Kosova dhe Down Syndrome Kosova mbajtën 12 takime gjatë vitit 2022 me zyrtarë publikë ku u diskutuan të drejtat e grave. Ndërsa që nga fillimi i numërimit, janë mbajtur 156 takime.

***Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor***

Të mbështetur nga FGK përmes iniciativave të saj Partnerët Kosova, Down Syndrome Kosova, Handikos Mitrovica dhe OJQ ATO kanë përfshirë 34 gra që avokojnë për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor cilësor në vitin 2022. Ndërsa që nga fillimi i numërimit nga RrGK, anëtaret e RrGK kanë përfshirë 1999 gra dhe vajza që të avokojnë për të drejten e tyre në kujdes shëndetësor cilësor.

# Jeta pa dhunë me bazë gjinore

Qëllimi kryesor i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë pa dhunë me bazë gjinore. Për ta arritur këtë, RrGK ka vazhduar punën e saj drejtë harmonizimit të kërkesave që vijnë nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e njohur si Konventa e Stambollit, tashmë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Konventa vendosë standarde për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ajo poashtu njeh obligimin e shteteve që ta adresojnë plotësisht dhunën me bazë gjinore dhe të gjitha format e saj, si dhe të marrin masa në parandalimin e dhunës ndaj grave, të mbrojë viktimat dhe të ndjekin penalisht kryesit e veprës.

RrGK ka ndërmarrë përpjekje të gjera duke përfshirë fushata vetëdijësuese, avokim për përmirësim të kornizës ligjore për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, ndihmë ligjore dhe trajnime, ndër të tjera, të mbështetura kryesisht nga ADA, Sida dhe UN Women. Megjithate, ishte e vështirë të analizohet ndikimi i përgjithshëm bazuar në treguesit e nivelit të ndikimit të vendosur nga RrGK në Strategjinë e saj. Për shkak të vonesave në lidhje me regjistrimin e popullsisë, dhe rrjedhimisht edhe për hulumtimin kombëtar të planifikuar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi dhunën me bazë gjinore, të dhënat nuk janë të disponueshme për matjen e ndryshimeve në disa tregues kyç. RrGK planifikon të punojë me qeverinë për të publikuar një hulumtim të tillë në vitet e ardhshme, duke mundësuar analizë më të mirë të ndikimit të programit të RrGK me kalimin e kohës.

RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS • KOSOVO WOMEN'S NETWORK • MREŽA ŽENA KOSOVA

## Përmirësimi i zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në familje, duke përfshirë përgjegjësinë institucionale për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROTOKOLLI SHTETËROR[1]
PËR
TRAJTIMIN E RASTEVE
TË DHUNËS SEKSUALE

RrGK, gjatë vitit 2022 ka dërguar komente të detajuara për Projektligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore, Ligji për Banim Social dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Duke qenë që këto ligje nuk kanë qenë në përputhje me Konventën e Stambollit, RrGK ka dërguar komente në mënyrë që ligji të përshtatet me Konventën e Stambollit dhe të ndahen përgjegjësi të qarta përmes tij. Ndarja e përgjegjësive mund të kontribuojë në përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore.

Në dhjetor të vitit 2022, Ministria e Drejtësisë lansoi Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Ky protokoll ka për qëllim standardizimin e veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale. Protokolli gjithashtu saktëson dhe qartëson përgjegjësitë e institucioneve për trajtim të këtyre rasteve. Në partneritet me Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe EULEX-in, RrGK udhëhoqi procesin e hartimit të këtij Protokolli së bashku me aktorët përkatës, të mbështetur nga UN Women. RrGK në bashkëpunim me

strehimoret organizuan tetë takime me Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje (MKKDhF). RrGK analizoi komentet dhe më pas dërgoi ato tek Ministria e Drejtësisë dhe ekspertja. Si rezultat, të gjitha komentet e dërguara nga MKKDhF dhe strehimoret u përfshinë në këtë protokoll.
Tutje, gjatë vitit 2022, RrGK në bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve hartuan dhe miratuan dy kurrikula, "Puna me viktima të dhunës në familje – trajtimi dhe referimi", dhe, "Puna me viktimat e krimeve seksuale dhe trafikimit".Me këto kurrikula, RrGK organizoi trajnimin dhe certifikimin e trajnerëve të cilët do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksualeRrGK trajnoi 15 punonjës socialë nga organizata joqeveritare dheçertifikoi 12 punonjës si trajner në mënyrë që këta të trajnojnë punëtorët e tjerë social që punojnë në Qendra për Punë Sociale (QPS). Këto kurrikula janë bërë të detyrueshme për punjësit social në QPS. Kjo do të kontribuojë në zbatimin e kornizës ligjore.

Përmes ndihmës juridike, RrGK ka mbështetur gratë që të kërkojnë drejtësi për dhunën që kanë përjetuar, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore përkatëse. Anëtaret e stafit të RrGK-së kanë mbështetur 30 raste, duke i informuar gratë për të drejtat e tyre, institucionet ku mund të drejtohen si dhe duke i referuar ato te avokati për ndihmë juridike. RrGK gjithashtu vazhdoi të mbështesë dy raste strategjike gjyqësore që filluan në vitin 2020, një rast ka përfunduar në 2022 kurse tjetri është ende duke vazhduar. Në total, deri me tani RrGK ka mbështetur katër raste strategjike gjyqësore. Gratë u referuan në institucionet përkatëse të drejtësisë, si dhe te psikologë të strehimoreve për këshillim. Gjithashtu, RrGK angazhoi një monitoruese të gjykatave, e cila i

ndoqi rastet e DhBGJ në gjykata, kjo drejt identifikimit të rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore.

Si rezultat i avokimit të vazhdueshëm të RrGK-së për mbështetjen e strehimoreve, në vitin 2021, Qeveria ka ndarë 900,000 €, ndërsa për vitin 2022, Qeveria ka ndarë 1,0,000€. Këto janë arritje të rëndësishme drejt zbatimit të kornizës ligjore, duke u mundësuar strehimoreve të kenë burimet që u nevojiten për të kryer punën e tyre të rëndësishme në përputhje me kornizën ligjore.

### *Zgjerimi i njohurive në lidhje me shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje, si dhe vetëdijesimi rreth mbizotërimit të dhunës në familje*

Në prill të vitit 2021, RrGK lansoi raportin hulumtues *"Nga Ligjet në Vepra!",* i cili informon RrGK-në dhe palët relevante të interesit për ndryshimet në njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme që nga viti 2015. Bazuar në gjetjet, gjatë vitit 2022, RrGK vazhdoi të organizoi iniciativa avokuese, për të siguruar që përfaqësuesit institucionalë dhe OSCG-të që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat që kanë vuajtur nga DhBGj, të kenë njohuri të shtuarapër nevojat e tyre. Për këtë qëllim, RrGK organizoi 21 takime me akterë të ndryshëm për të avokuar për zbatimin e kornizës ligjore, duke përfshirë rekomandimet e hulumtimit. RrGK gjithashtu ka organizuar dy cikle të trajnimit me strehimoret e Kosovës me temat, "Menaxhimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore", dhe, "Djegia profesionale (burnout)". Në të dy ciklet e trajnimit gjithsej morën pjesë 64 punonjëse të strehimoreve. Si vazhdimësi e trajnimit, "Menaxhimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore", RrGK në bashkëpunim me strehimoret trajnuan Mekanizmin

Koordinues Kundër Dhunës në Familje në tetë regjione të ndryshme të Kosovës ku morën pjesë 102 pjesëmarrës nga nga institucionet përgjegjëse lokale.

### ***Institucionet dhe akterët e tjerë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën korniza ligjore për dhunën në familje është zbatuar***

Për të informuar palët e interesuara për zbatimin e kornizës ligjore dhe për të siguruar zbatimin e duhur të saj, RrGK ka mbajtur takime avokuese me institucionet në vijim: Ministrinë e Drejtësisë; Ministren dhe Zëvendësministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministrinë e Financave, konkretisht Drejtorinë e Departamentit për Familje dhe Shërbime Sociale; Mbrojtësit e Viktimave, Policia e Kosovës, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Inspektoriati Policor; dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile, si Instituti i Kosovës për Drejtësi, Kallxo.com, CLARD, Qendra për



*Drejtorja ekzekutice e RrGK, Igballe Rogova takohet me Ministren e Arsimit znj. Nagavci: flasin për nismat e përbashkëta, gusht, 2022*

Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve - Prishtinë, Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria", Zensko Pravo, Qendra e Përfshirjes së Grave, Shtëpia e Sigurtë - Gjakovë, Qendra e Strehimit të Grave dhe Fëmijëve - Prizren, Qendra për Mirëqenien e Gruas, dhe Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" . Gjatë takimeve, RrGK diskutoi me ta gjetjet e hulumtimit dhe rekomandimet për secilin institucion, duke u siguruar që ata ishin të vetëdijshëm për përmirësimet e nevojshme për zbatimin më të mirë të kornizës ligjore . RrGK ka avokuar për përmirësimin e reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, si dhe diskutuar mundësitë për bashkëpunim në adresimin e DhBGj-së, përmes drejtësisë, shërbimeve sociale dhe arsimit. Për më tepër, puna e RrGK-së në këtë fushë gjatë vitit 2022 u përmend në 44 artikuj të mediave, ndërsa që nga viti 2019 u përmend në 136 artikuj. RrGK vazhdon të jetë pjesë e Grupit Ndërministror Kundër Dhunës në Familje që udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë dhe RrGK vazhdoi të informojnë palët e interesuara për aktivitetet që do të zbatojë, të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave.

### *Angazhimi i RrGK-së dhe anëtareve të saj për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje*

RrGK ka bashkëpunuar me OSHC-të që ofrojnë shërbime, kryesisht me strehimoret, për këshillimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Përmes bashkëpunimit me strehimoret, RrGK promovoi edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ngriti vetëdijen për mekanizmat e ndryshëm ku mund të referohen si të mbijetuarit e dhunës po ashtu dhe ofruesit e shërbimeve për ta. Që nga janari i vitit 2022,

mbi 500 gra dhe fëmijë janë mbështetur, këshilluar dhe referuar nga strehimoret. Çdo grua është informuar për të drejtat e saj dhe rolin e institucioneve.

Përmes punës së RrGK dhe anëtareve të saj, gjatë vitit 2022, 1671 gra dhe burra më të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre. Që nga fillimi i numërimit të RrGK, 26,898 gra dhe burra janë vetëdijesuar më mirë për kornizën ligjore, gjë që mund të kontribuojë në avancimin e zbatimit të saj pasi njerëzit janë më të pozicionuar për t'i mbajtur përgjegjëse institucionet .

Gjatë vitit 2022, RrGK dhe anëtaret e saj kanë përfshirë 559 gra dhe burra të ndryshëm në fushata për ngritje të vetëdijes dhe dhe që kanë ndërmarrë veprime në drejtim të reduktimit të dhunës me bazë gjinore, ndërsa që nga fillimi i numërimit janë përfshirë 2983 persona.

RrGK ka vazhduar që të mbështesë strehimoret dhe të ngrisë kapacitet e tyre përmes trajnimeve të shumta të organizuara bashkarisht. Përmes mbështetjes së RrGK-së strehimoret kanë filluar që të takohen me Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje në baza mujore të rregullta dhe të trajtojnë/diskutojnë rastet specifike të cilat kanë qenë të strehuara në strehimore. Përmes këtyre takimeve, dy viktimave të dhunës në familje në Prizren iu është gjetur banim social dhe shumë të tjera janë trajtuar me prioritet nga institucionet lokale.

Më tej, RrGK ishte pjesë e takimeve të Grupit Koordinues Ndërministror kundër Dhunës në Familje, të koordinuara nga Koordinatorja Nacionale kundër Dhunës në Familje nga Ministria e Drejtësisë. Prania e RrGK-së në këto takime lehtëson monitorimin e punës së të gjitha institucioneve përgjegjëse për trajtimin e dhunës në familje, kjo drejt zbatimit të kornizës ligjore përkatëse.

*‘’RrGK bën çmos që viktimat e dhunës me bazë gjinore të jenë të sigurta dhe të arrijnë drejtësinë. Falënderimi im ndaj RrGK-së është i mangët në krahasim me mbështetjen dhe ndihmen që RrGK më ka ofruar gjatë gjithë kohës.’’* – Grua, e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore.

Përveç kësaj, RrGK po ashtu ka vazhduar monitorimin e rasteve të DhBGJ-së të cilat janë adresuar në Gjykata Themelore, kryesisht në Prishtinë, por edhe në komunat e tjera sipas nevojës. Në vitin 2022, RrGK ka monitoruar 89 raste te dhunës me bazë gjinore.

Tri anëtare të RrGK, Humanus Vita, QPDG dhe OJQ Jeta janë angazhuar në 10 iniciativa avokuese në drejtim të avancimit të zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në familje. Ndërsa që nga fillimi i numërimit 75 anëtare të RrGK-së kanë ndërrmarë 141 inicativa në këtë drejtim.

***Rritja e performancës dhe cilësisë së shërbimeve të strehimoreve, veçanërisht atyre për rehabilitimim dhe riintegrimim***

RrGK, në konsultim me strehimoret, trajnuan Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës me në Familje për, "Menaxhimin e rasteve – trajtimi dhe referimi". Në këto trajnime morën pjesë gjithsej 102 pjesëmarrës nga institucionet lokale. Pjesëmarrësit diskutuan rreth sfidave dhe problemeve që institucionet lokale dhe MKKDhF-ja kanë. Ata gjithashtu diskutuan edhe për mundësitë e bashkëpunimit tutje në mes institucioneve lokale dhe RrGK-së. Përveç kësaj, RrGK organizoi trajnime edhe me përfaqësuesit e strehimoreve të Kosovës. Sic u përmend, RrGK organizoi trajnime. me temën, "Menaxhimi i rasteve – trajtimi dhe referimi", dhe, "Djegia profesionale (burnout)" ku morën pjesë 64 pjesëmarrës. Pjesëmarrësit diskutuan ligjet, Konventën e Stambollit, menaxhimin e çështjeve, ngarkesat e stafit në punë, financat e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tyre dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

**Përmirësimi i vetëdijesimit dhe vëmendjes në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve, në trajtimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual**

Përmes monitorimit të rasteve në gjykata dhe përfaqësimit të rasteve që janë drejtuar në RrGK, është vërejtur se ndërgjegjësimi i zyrtarëve është përmirësuar në lidhje me dhunën në familje, edhe pse nevojiten ende përmirësime, veçanërisht në lidhje me format e tjera të DhBGj-së. Pas rekomandimeve nga hulumtimi dhe avokimit të RrGK-së, Qeveria zbatoi katër rekomandime në vitin 2022: 1. Rritja e buxhetit për strehimoret; 2. Hartimi dhe lansimi i Protokollit Shtetëror për Trajtim të Rasteve të Dhunës Seksuale; 3. Kurrikula Puna me Viktimat e dhunës në familje- trajtimi dhe referimi; 4. Kurrikula për Punën me Viktimat e Krimeve Seksuale dhe Trafikimit. Siç u theksua, poashtu u mbajtën trajnime per punëtor social në dy temat e lartëpërmendura, ku u vlerësuar për 35% u rritën njohuritë e tyre mbi trajtimin e dhunës në familje, dhunës seksuale dhe trafikimit.




*Fushata online e RrGK-së për ndërgjegjësimin e qytetarëve për dhunën seksuale, 2022*

Tutje, RrGK dhe anëtarët e saj monitoruan dhe analizuan ofrimin e shërbimeve nga punonjësit socialë në Qendrat për Punë Sociale (QPS) në Kosovë. Analiza është bërë në dy faza, para dhe pas trajnimit dhe punës së RrGK dhe të anëtarëve të saj me QPS-të. Është vënë re se ka patur përmirësim të dukshëm në disa aspekte, sa

i përket ofrimit të shërbimeve. Për shembull në vitin 2020 vetëm 61% e grave kishin patur menaxher rasti ndërsa në vitin 2022, 81% e rasteve u ishte caktuar një menaxher rasti nga QPS.



Hulumtimi i mëparshëm i RrGK-së ka ilustruar se pak njerëz, përfshirë edhe institucionet përkatëse, e kanë kuptuar se çfarë përfshin dhuna seksuale dhe se ajo është krim. Si rezultat, pak raste janë raportuar apo trajtuar ndonjëherë nga institucionet. Prandaj,gjatë vitit 2022 pati disa fushata vetëdijësuese përmes rrjeteve sociale për dhunën seksuale. Këto fushata përfshinë 10 poste të ndryshme rreth asaj se çfarë është dhuna seksuale, dallimi në mes ngacmimit seksual, sulmit seksual dhe dhunimit si dhe fushata trajtoi përgjegjësitë e institucioneve në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës seksuale. Fushata arriti tek 562,256 njerëz, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre. Gjersa më shumë njerëz kuptuan se çfarë përfshin dhuna seksuale, se është e paligjshme dhe si ta raportojnë atë, këto fushata kontribuan në rritjen e numrit të raportimeve të dhunës me bazë gjinore në institucionet përkatëse.Të dhënat e policisë në vitin 2022 tregojnë se është rritur dukshëm numri i raportimeve të dhunimeve (88 raste), ngacmime seksuale (87 raste) dhe sulm seksual (62 raste), krahasuar me vitin 2019 ku ishin më pak të raportuara: dhunime (40 raste), ngacmime seksuale (24) dhe sulme seksuale 46 raste.

RrGK mori pjesë në disa demonstrata dhe protesta për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën me bazë gjinore dhe për të bërë thirrje për reagim të përmirësuar institucional.Në janar 2022, RrGK mbështeti aktivistët në Skenderaj për të dënuar vrasjen e L.Q nga bashkëshorti. Protestat mblodhën qindra qytetarë. Më pas,vrasësi i viktimës u dënua shpejt nga sistemi i drejtësisë. Më 8 mars RrGK iu bashkua protestës vjetore të Ditës Ndërkombëtare të Gruas"Marshojmë s'festojmë kundër patriarkatit që vret". Qytetarët ngritën zërin për të protestuar ndaj padrejtësive me të cilat përballen gratë, duke përfshirë femicidin dhe pankarta me mesazhe feministe shiheshin në ballkonet e tyre. RrGK gjithashtu mori pjesë në fushatën ndërkombëtare "këpucët e kuqe" duke vendosur 48 palë këpucë të kuqe përballë ndërtesës së Qeverisë, që përfaqësojnë 48 gra të vrara nga burrat.

*Më 8 mars, RrGK organizoi para Qeverisë instalimin "Këpucët e Kuqe", që simbolizonte gratë e vrara nga femicidi*Në gusht 2022, RrGK mbështeti protestën dhe përcjelli nga afër trajtimin institucional të dhunimit të vajzës 11 vjeçare deri në dënimin e kryesve të veprës. Në dhjetor 2022, RrGK gjithashtu mbështeti protestën për vrasjen e gruas shtatzënë H.M në oborrin e Klinikës Gjinekologjike – QKUK. RrGK vazhdon të monitorojë trajtimin institucional të rastit. Protesta mblodhën qindra qytetarë, ndërsa vrasësi vrau veten, duke mos pranuar të dorëzohej tek policia. RrGK ka pasur paraqitje në media këtë rast më shumë se 10 herë, në të cilat RrGK vazhdoi të avokojë dhe të ofrojë rekomandime konkrete për të gjitha institucionet se si të mbrojnë viktimat dhe të ndalet dhuna sistematike, ndër të tjera.

RrGK në vazhdimësi gjatë vitit 2022 ka reaguar për raste të vrasjes së grave, ngacmimeve seksuale, sulmeve seksuale dhe dhunimeve. Për më tepër, RrGK ka dënuar gjuhën diskriminuese dhe seksiste të përfaqësuesve të institucioneve ndaj grave dhe vajzave.

Tutje, RrGK ka vazhduar të bëjë ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për dhunën dhe mënyrën e raportimit të saj përmes ekspozitës publike "Dhuna nuk fshehët brenda mureve".. Në vitin 2022, fushata e RrGK vizitoi pesë qytete: Malishevë, Fushë Kosovë, Viti, Ferizaj dhe Klinë, të mbështetur nga ADA.

***Më shumë qytetarë  të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre***

Ekspozita, deklaratat për shtyp, paraqitjet televizive dhe protestat synojnë të informojnë më shumë njerëz për të drejtat e tyre. RrGK ka mbështetur strehimoret në shërbimet e tyre këshilluese lidhur me të drejtat dhe ka referuar raste te avokati i RrGK-së, sipas nevojës. Siç u përmend, RrGK ka mbështetur 30 raste në vitin 2020, duke i informuar gratë për të drejtat e tyre, institucionet në të cilat mund t'i drejtohen dhe duke i referuar ato te avokati për ndihmë juridike. Sa i përket dy rasteve gjyqësore,njëri ka përfunduar gjatë vitit 2022 kurse tjetri është ende në vazhdim e sipër. Në përgjithësi, rreth 1,500 qytetare e qytetarë kanë marrë pjesë në protestat e organizuara nga RrGK-ja dhe partnerët e saj. Ekspozita "Dhuna nuk fshehet brenda mureve" informoi fizikisht 2500 persona (1548 gra dhe 952 burra), lidhur me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre.

Tutje përmes FGK anëtaret e RrGK kanë informuar 1671 gra dhe 1212 burra përmes iniciativave të tyre të zbatuara gjatë vitit 2022. Anëtaret e RrGK poashtu kanë përfshirë mbi 500 persona në fushata sensibilizuese dhe që ndërmoren veprime për reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

## Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual

***Koordinimi mes OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike dhe vendeve tjera të punës është përmirësuar në aspektin e instalimit të mekanizmave më të mirë për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual***

Gjatë vitit 2022, Republika e Kosovës ka hartuar Strategjinë së Re dhe Planin e Veprimit 2022-2026 për Parandalimin e DHBGJ-së, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, për të cilat RrGK dhe anëtaret kanë dhënë kontributin e tyre bazuar në ekspertizën e tyre. Në këto dokumente po trajtohen të gjitha format e DhBGj-së, përfshirë edhe ngacmimin seksual. Përveç kësaj, në dhjetor të vitit 2022 u lansua Protokolli për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale që i kontribon hetimit të këtyre rasteve, i cili u hartua në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore e mbështetur nga UN Women. Ai vendosi politika dhe procedura për hetimin dhe trajtimin e rasteve, pasi procedura të tilla nuk ekzistonin më parë. RrGK gjithashtu ka dërguar komente dhe rekomandime të qarta në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore për format e tjera të DhBGj-së, ndarjen e përgjegjësive dhe hetimin e rasteve të dhunës seksuale. Këto ndryshime në legjislacion do të adresojnë raportimin e mangët dhe hetimin e ngacmimeve seksuale.

Në vitin 2022, RrGK gjithashtu filloi të punojë me punëdhënës të ndryshëm për të vlerësuar politikat e tyre në vendin e punës dhe për t'i mbështetur ata në përdorimin e mekanizmave më të mirë për trajtimin e ngacmimeve seksuale në vend të punës.

Mbi të gjitha, në vitin 2022, RrGK ka mirëpritur në zyret e saj katër raste të ngacmimeve seksuale dhe sulmeve seksuale dhe i ka adresuar ato tek avokati dhe institucionet e tjera kompetente. RrGK mbetet në kontakt të vazhdueshëm me këto raste dhe monitorim të institucioneve se si rastet e dhunës seksuale po trajtohen.

## Përmirësimi i mbështetjes institucionale dhe publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

RrGK kërkoi mbështetje në disa takime me zyrtarë, për të inkurajuar Qeverinë që të zgjasë periudhën gjatë së cilës njerëzit mund të aplikojnë për përfitime si të mbijetuar/a të dhunës sipas ligjit aktual, duke pasur parasysh se mund të duhet kohë që njerëzit të jenë në gjendje ta raportojnë atë; dhe që ligji të ndryshohet për të zgjatur periudhën e konfliktit, për të përfshirë më mirë përfitimet për gratë e etnive të ndryshme, sipas rekomandimeve të Amnesty International.

RrGK dhe anëtaret e saj të specializuar në këtë fushë vazhdimisht punojnë për tënjohur dhe respektuar të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe ka disa organizata anëtare që punojnë në këtë fushë. RrGK ka vazhduar të monitorojë zhvillimet në këtë drejtim.

### *RrGK dhe anëtaret e saj përkrahin personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës*

Përmes FGK-së, RrGK ka mbështetur organizatat anëtare të cilat ofrojnë shërbime për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës. Këto organizata anëtare të RrGK-së vazhduan të mbështesin personat që

kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës. Konkretisht, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave mori mbështetje nga FGK për të ofruar "shërbime psiko-sociale për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë". QPDG ka punuar ngushtë me 30 gra të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe ka ngritur vetëdijësimin për të drejtat e tyre në qasje në kujdesin shëndetësor.

## Fuqizimi Ekonomik i Grave

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike. Është bërë progres drejt këtij qëllimi, siç ilustrohet nga hapat e ndërmarrë drejt realizimit të objektivave dhe rezultateve të mëposhtme.

### Përmirësimi i kushteve për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore

Gjatë vitit 2022, RrGK së bashku me organizatat e saj partnere dhe anëtarët e Koalicionit Rajonal kundër Diskriminimit me Bazë Gjinore ndaj Grave në Punë, finalizuan nismën rajonale katër-vjeçare në adresimin e diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës. Ata morën pjesë në 22 nisma të përbashkëta avokuese të ndërmarra që përfshinin bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe palëve të tjera të interesuara drejt zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit. Nisma kishte disa rezultate të detajuara në seksionet e mëposhtme.

Përveç kësaj, RrGK së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës të mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë në Kosovë (UNFPA) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), përfunduan me sukses një iniciativë për promovimin e politikave miqësore ndaj familjes në vendet e punës. Përmes kësaj nisme të përbashkët, RrGK publikoipërmbledhjen e politikave mbi politikat miqësore ndaj familjes me rekomandime për përmirësimin e kornizës ligjore dhe harmonizimin e saj me Direktivën e BE-së për Balancimin Punë-Jetë. Gjithsej 13 zyrtarë qeveritarë, akterë të sektorit privat, përfaqësues të shoqërisë civile zgjeruan të kuptuarit dhe njohuritë e tyre mbi politikat familjare të përgjegjshme gjinore dhe 61 punonjës mësuan më shumë rreth politikave të përgjegjshme gjinore përmes takimeve ndërgjegjësuese të mbajtura gjatë kësaj nisme. Dy fushata vetëdijesimi publik që përfshinin personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e pakicave etnike, promovuan ndryshimet e nevojshme ligjore në lidhje me pushimin e lehonisë, atësisë, prindëror dhe të kujdestarëve. RrGK dhe anëtaret e saj mbështetën 37 biznese në Prishtinë, Lipjan, Viti, Skenderaj dhe Mitrovicë në promovimin e vendeve të punës miqësore ndaj familjes.

### *Institucionet dhe akterët kryesorë më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për ta adresuar atë*

RrGK, së bashku me partnerët e saj rajonalë, botuan shtatë raporte për diskriminimin me bazë gjinore dhe punën në rajon, duke përfshirë një raport për secilin nga gjashtë vendet e BP-së dhe një raport rajonal, mbështetur nga BE dhe Sida Këto raporte përmbanin rekomandime specifike për institucionet për të adresuar më mirë diskriminimin me bazë gjinore. RrGK dhe partnerët e saj rajonal vazhduan të ofrojnë ndihmë juridike dhe të mbështesin njerëzit në kërkimin e drejtësisë për diskriminimin me bazë gjinore në punë, duke sjellë vëmendjen e institucioneve ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë.Po ashtu, RrGK mbështeti katër organizata anëtare për të informuar palët e ndryshme të interesit në nivel lokal për përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore ndaj grave dhe për të promovuar politikat miqësore për familjen dhe vendet e punës, veçanërisht gjatë takimeve me përfaqësues të bizneseve, financuara nga ADA përmes UNFPA-së.



*Organizata anëtare e RrGK-së "Drugeza" në Skënderaj shpërndau posterë në kuadër të iniciativës "Promovimi i Politikave Miqësore për Familjen", shkurt 2022*

***Vetëdijesimi në mesin e palëve të interesit, duke përfshirë zyrtarët, OSHC-të dhe sindikatat lidhur me kornizën ligjore për diskriminimin përkatës dhe me mënyrat për përmirësimin e zbatimit të saj***

RrGK, në bashkëpunim me partnerët e saj rajonalë, mbajti 84 takime për ngritjen e vetëdijesimit të palëve të interesit. Përfaqësuesit e koalicionit tëlartpërmendur të koordinuar nga RrGK-ja, duke marrë pjesë në panele, seminare dhe konferenca të ndryshme kanë rritur vetëdijesimin e palëve të interesit për konceptet e diskriminimit dhe mënyrat për ta parandaluar atë. Koalicioni ka nisur një fushatë në internet për mes të cilës i informon punëtorët për ngacmimet seksuale në punë dhe shkeljet e mundshme të të drejtave, përfshirë gjatë punës në kushte pandemie. Fushata gjithashtu i ofroi informacione njerëzve për ndihmën juridike falas nëse ata dëshirojnë të raportojnë ngacmimet seksuale, diskriminimin me bazë gjinore dhe shkeljet e të drejtave të grave punonjëse. Mediet kanë mbuluar 35 herë çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin e grave në



*Organizata anëtare e RrGK-së "Youth Center Lipjan" në Lipjan, diskutim në kuadër të iniciativës "Promovimi i Politikave Miqësore për Familjen", janar 2022*

punë, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes për këtë temë. Koalicioni zhvilloi edhe një fushatë tjetër në media sociale për të informuar qeveritë, publikun dhe bizneset për përfitimet e Direktivës së BE për Balancimin e Punës dhe Jetës. Fushata njëmujore ka arritur deri tek së paku 100,000 burra dhe gra në Ballkanin Perëndimor.

***Disponueshmëria e informacionit, përfshirë hendekun gjinor të pagave, ekonominë joformale dhe skemat e sigurimit sociale është përmirësuar***

RrGK ka avokuar për nevojën e një analize gjinore në ekonominë joformale, përmes takimit të MSA-së për Ekonominë dhe Financat, si dhe në takimet me BE-në, Qeverinë e Kosovës dhe veçanërisht me zyrtarë në Zyrën e Kryeministrit.RrGK theksoi se është thelbësore të bëhej një analizë e tillë gjinore për të informuar ndërhyrjet e planifikuara të Qeverisë në lidhje me adresimin e ekonomisë joformalenë Programin e Reformës Ekonomike 2022-2024 si dhe në Planin e Veprimit ERA II. RrGK ka iniciuar planet për një analizë të tillë gjinore në konsultim të ngushtë me palët e interesuara të qeverisë dhe BE-në, si dhe ka mbledhur të dhëna për këtë analizë si pjesë e një ankete më të gjerë kombëtar në mbarë Kosovën të financuar nga BE-ja dhe Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisës e Kombeve të Bashkuara ( FAO).

Po ashtu, RrGK ka avokuar për skema më të mira të sigurimeve sociale dhe për ndryshimin e modelit të skemave sociale përmes MSA-së për Politikat Sociale dhe Punësimin, duke u mbështetur nga hulumtimet paraprake të RrGK-së mbi dallimet gjinore në qasjen në sigurimet sociale.

Në vitet e kaluara, gjatë periudhës së kësaj Strategjie të RrGK-së, ABGj publikoi një raport mbi hendekun gjinor të pagave në Kosovë, i cili e bëri më të disponueshme informacionin për këtë çështje. RrGK ka përdorur dhe referuar këtë raport në hulumtimin e saj dhe avokimin e bazuar në prova.

Përveç kësaj, FAO kontraktoi RrGK-në për të kryer analizën e parë gjithëpërfshirëse gjinore në sektorin e bujqësisë në Kosovë në vitin 2022 e cila përpiqet të të drejtojë punën e Qeverisë së Kosovës, FAO-s dhe aktorëve të tjerë të zhvillimit ndërkombëtar në investime të bazuara në prova drejt avancimit të angazhimit të grave në bujqësi. Studimi do të publikohet në vitin 2023.

***Qasja në drejtësi në rastet e diskriminimit gjinor në punë është përmirësuar***

Së bashku me partnerët e tij të Koalicionit, RrGK e lehtësoi qasjen e grave në drejtësi duke iu ofruar atyre ndihmë juridike, përfshirë gjatë pandemisë COVID-19 dhe përgjatë vitit 2022. RrGK ka vazhduar të bashkëpunojë me Qendrën për Ndihmë Juridike Falas të Institutit të Kosovës për Drejtësi, për të ofruar përfaqësim ligjor. RrGK dhe partnerët e saj gjithashtu vazhduan monitorimin e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore në drejtim të përmirësimit të trajtimit të këtyre rasteve nga institucionet relevante. RrGK dhe Koalicioni mbështetën katër raste strategjike gjyqësore në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut që kanë të bëjnë me diskriminimin me bazë gjinore ndaj grave në punë. Së bashku përmes kësaj nisme, OShC-të në të gjithë BP-në asistuan 199 raste që përfshinin diskriminim me bazë gjinore dhe shkelje të të drejtave të punës, duke ofruar këshilla ligjore dhe ndihmë juridike.

***Më shumë mundësi të përballueshme për përkujdesje të fëmijës janë në dispozicion***

RrGK-ja ka vazhduar të avokojë te qeveria që të hap më shumë qendra të kujdesit për fëmijët, si dhe te donatorët ndërkombëtarë që të mbështesin këtë gjë. RrGK theksoi vazhdimisht rëndësinë që Kosova të ofrojë më shumë mundësi të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve si pjesë e komenteve të RrK-së mbi Raportin e KE-së për Kosovën, Programin e Reformës Ekonomike 2022-2024, dhe Agjendën e Reformës Evropiane II), për të informuar takimin e NK të MSA-së; dhe gjatë një takimi me Ministrinë i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)..

Po ashtu, RrGK së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës të mbështetur nga UNFPA dhe ADA, ka punuar me zyrtarë, punëdhënës, zyrtarë lokal, punëtorë dhe punëtore me qëllim të informimit të tyre mbi politikat miqësore me familjen, duke përfshirë mundësitë që punëdhënësit të ofrojnë mbështetje për përkujdesje të fëmijëve për punonjësit. Përmes mbështetjes së organizatave anëtare në komunën e Lipjanit, Vitisë, Skënderajit dhe Mitrovicës, shumë akterë në nivel komunal janë informuar mbi këto politika dhe munësitë e aplikimit të tyre edhe tek bizneset më të vogla. Për sa i përket ndikimit, pjesërisht për shkak të avokimit të RrGK-së, ndër faktorët e tjerë, Kosova ka rritur numrin e qendrave për përkujdesjen e fëmijëve nga 110 në 2017 në 256 në 2023.

## Rritet përqindja e grave që kanë qasje në trashëgimi dhe pronë

RrGK nuk kontribuoi drejtpërdrejt në rritjen e përqindjes së grave që kanë qasje në trashëgimi ose pronë në vitin 2022. Megjithatë, anëtaret e RrGK-së vazhduan të punojnë në këtë fushë.

***Më shumë qytetarë të vetëdijesuar lidhur me të drejtat e grave për trashëgimi dhe pronësi***

Permes FGK, anëtaret e RrGK, Norma dhe Aleanca e Grave për Integrim, kanë ngritur vetëdijën e 111 personave për të drejtat e grave në trashëgimi në vitin 2022..

RrGK së bashku me anëtarët e saj tashmë e ka tejkaluar objektivin e për të arritur 9,470 persona sipas Strategjisë aktuale të RrGK-së, duke arritur tek 10,118 gra dhe burra të ndryshëm për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me të drejtat e grave në trashëgimi dhe të drejtat pronësore.

**Përmirësimi i perspektivës gjinore në reformat që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE**

Siç ilustrohet rezultatet e lartcekura, komentet e RrGK-së për dokumentet që lidhen me anëtarësimin në BE kanë kontribuar në përmirësimin e perspektivës gjinore në reformat që lidhen me BE-në, duke përfshirë ato që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave. Disa nga rekomandimet e RrGK-së janë marrë parasysh nga qeveria dhe/ose BE. Për shembull, në vitin 2022, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i referohej gjinisë 125 herë në mënyra të ndryshme, një rritje krahasuar me 98 herë në vitin 2020. Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE, duke përfshirë monitorimin e politikave dhe

programeve të BE-së në Kosovë është bashkëfinancuar nga BE-ja dhe Sida, si dhe nga Fondacioni Kvinna till Kvinna..

### *Monitorimi i politikave dhe programeve të BE-së në Kosovë nga perspektiva gjinore është përmirësuar*

RrGK ka vazhduar të rishikojë veprimet dhe kontratat e mbështetura nga BE-ja në Kosovë, në drejtim të integrimit të një perspektive gjinore brenda këtyre dokumenteve. Në vitin 2020, RrGK zhvilloi një rishikim të shpejtë të programeve të BE-së në zhvillim e sipër për të identifikuar fushat ku kontraktorët mund të integrojnë më mirë perspektivën gjinore në punën e tyre dhe në vitin 2021, RrGK ka vazhduar me këto rekomandime me BE-në, kontraktorët dhe përfituesit, përfshirë qeverinë e Kosovës. Më 2021, RrGK ka vazhduar monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor të BE-së (PVGj) II në Kosovë dhe në rajonin e BP-së, duke përfshirë edhe ndihmën e ofruar Zyrës së BE-së në Kosovë në hartimin e Planit të Zbatimit në Nivel Vendi për PVGj IIINdërsa përgjatë vitit 2022, RrGK ka realizuar një raport monitorimi në nivel vendi, për nivelin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE, duke prekur edhe aspektin e implementimit të PVGj nga zyra e BE-së në Kosovë. Tutje, zyrtarët e BE-së dhe ata të qeverisë ndërmorën 8 veprime për të adresuar më mirë problemet dhe situatat e ngritura nga gratë, për integrimin e perspektivës gjinore në proces të para-anëtarësimit në BE, si rezultat i avokimit të RrGK-së:

1. Programi i Reformave në Ekonomi 2022-2023, u konsultua me RrGK-në dhe u publikua me perspektivë të përmirësuar gjinore, duke përfshirë rekomandimet e RrGK-së;
2. Zyra e Kryeministrit publikoi Planin e Veprimit të ERA II, me rekomandimet e RrGK të përfshira në të – si dhe u zotua të përfshijë RrGK dhe OShCG në monitorimin dhe zbatimin e ERA II;
3. Zyra e BE-së në Kosovë ftoi OShCG-të për të kontribuar me rekomandime për Raportin e vitit 2022 të Komisionit Evropian për Kosovën;
4. Zyra e BE-së në Kosovë si dhe Drejtorati i Përgjithshëm i BE për Fqinjësi dhe Negocim të Zgjerimit organizuan takim konsultativ me RrGK për hartimin e Programit për Reforma në Ekonomi, të vitit 2022, për të futur perspektivën gjinore në këtë dokument;
5. Zyra e BE-së në Kosovë konsultoi organizatata e grave, para takimit të BE-së me qeverinë e Kosovës në kuadër të strukturave MSA në Kosovë;
6. Qeveria e Kosovës konsultoi OShCG-të për rreth katër takime të MSA-së;
7. Raporti i Kosovës i Komisionit Evropian 2022 u publikua me rekomandime të RrGK dhe OShCG-ve dukshëm të integruara;
8. Zyrtarët e BE-së takuan OShCG-të në Bruksel, dhe u zotuan të vazhdojnë komunikimin në lidhje me çështjet të cilat gratë i konsiderojnë prioritet.

## Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor

Për shkak të ndryshimeve në kontekstin politik, financave të pamjaftueshme dhe lëvizjen e stafit, RrGK është përballur me disa sfida në zbatimin e këtij programi sipas Strategjisë aktuale të RrGK-së. Për here të parë nga viti 2021, RrGK siguroi fonde për arritjen e këtij objektivi afatgjatë, drejt përmirësimit të qasjes në edukim cilësor shëndetësor dhe të ndjeshëm gjinor.Po ashtu, në vitin 2022, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me RrGK, i cili ofron bazën për bashkëpunimin tonë në të ardhmen drejt ri-realizimit të këtyre objektivave. Së bashku me organizatat anëtare të RrGK-së, janë bërë plane për iniciativa shtesë në kuadër të këtij programi, të mbështetura nga RrGK përmes FGK-së, financuar nga ADA dhe Sida. Iniciativat e mbështetura nga FGK-ja do të fillojnë të zbatohen në vitin 2023. Pra, RrGK do të angazhohet më tej në realizimin e objektivave të saj të planifikuara në kuadër të këtij programi në vitin 2023 dhe vitet në vijim.

Ndërkohë, si rezultat i përpjekjeve të përmendura të RrGK-së, zyrtarët qeveritar janë zotuar të përmirësojnë qasjen në qendra të fëmijëve dhe kjo mund të kontribuojë në përmirësimin e qasjes së vajzave (dhe djemve) në edukimin e hershëm.

## Rritja e numrit të qendrave të kujdesit për fëmijë në proporcion me numrin e fëmijëve në nevojë

Krijimi i më shumë qendrave të kujdesit ndaj fëmijëve dhe institucioneve parashkollore mund të krijojë vende pune, të kontribuojë në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore dhe të përmirësojë rezultatet arsimore për fëmijët përmes kualifikimit më të mirë për punë të mëvonshme. Gjatë viteve të kaluara, RrGK ndërmorri pesë nisma avokuese për më shumë qendra parashkollore dhe të përkujdesit për fëmijë.

Pjesërisht për shkak të punës avokuese të RrGK-së, e plotësuar me punën e të tjerëve, numri i qendrave të kujdesit për fëmijët në Kosovë është rritur nga 110 në 2017 në 256 në 2023.Në vitin 2022, RrGK ka marrë informacione se qeveria, me mbështetjen e donatorëve, planifikon të ndërtojë më shumë qendra për kujdesin e fëmijëve. RrGK po monitoron nga afër këtë proces. RrGK në bashkëpunim me anëtaret e saj do të avokojë për inspektime më të mira të institucioneve parashkollore dhe qendrave të kujdesit për fëmijë në lidhje me cilësinë e arsimit transformues gjinor të ofruar.

### *Më shumë zyrtarë janë të vetëdijshëm për nevojën për më shumë qendra parashkollore dhe qendra të kujdesit për fëmijë*

Siç u përmend, RrGK ka ndërmarrë së paku pesë iniciativa për të avokuar për hapjen e më shumë qendrave parashkollore dhe qendrave të kujdesit për fëmijët në Kosovë, duke përfshirë edhe gjatë një takimi me MASHTI, si dhe lidhur me Raportin e KE-së për Kosovën, MSA-në për Politikën Sociale dhe Punësimin si pjesë e Projektligjit për Arsimin e Hershëm, Draft Strategjisë për Arsimin dhe Draft Strategjisë Kombëtare për Zhvillim. Ndërsa, që nga fillimi i numërimit dhe për më shumë qendra parashkollore dhe

ato për përkujdesjen e fëmijëve në vitin 2019, RrGK ka ndërmarrë 16 iniciativa të tilla avokuese për të rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve për këtë çështje serioze.

***Institucionet parashkollore inspektohen më shpesh lidhur me atë se sa po e zbatojnë legjislacionin mbi edukimin parashkollor***

Vetëm organet përkatëse qeveritare mund të kryejnë inspektime, kështu që RrGK mund të avokojë vetëm për përmirësimin e inspektimeve nga perspektiva gjinore. Për shkak të vonesave që rezultuan nga ndryshimet në kontekstin politik, lëvizja e stafit dhe financimi i pamjaftueshëm, RrGK nuk mundi të mbledhë informacione të mjaftueshme për të avokuar mbi këto çështje gjatë Strategjisë së saj aktuale. Megjithatë, kjo do të lidhet me punën e planifikuar të RrGK-së në kuadër të Strategjisë së saj të ardhshme.

## Përmirësimi i kurrikulës dhe teksteve shkollore nga perspektiva gjinore

***Përpilohen rekomandimet për përmirësimin e kurrikulës dhe iu dorëzohen akterëve relevant***

***Institucionet mbahen më të përgjegjshme për mësimdhënien në lëndën e edukimit seksual në shkolla***

Në vitin 2022, RrGK ndërmori hapa drejt forcimit të bashkëpunimit të saj me MASHTI-in duke siguruar kështu një bashkëpunim afatgjatë i cili do të çojë përmirësimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies (pedagogjisë)nga perspektiva gjinore. MASHT ra dakord që RrGK të marrë pjesë në grupet e ardhshme punuese lidhur me parandalimin e përforcimit të stereotipeve gjinore dhe roleve tradicionale gjinore përmes edukimit.

Në vitin 2022, RrGK ka komentuar edhe projektligjin për edukim të hershëm, përmes procesit të konsultimit publik. RrGK theksoi nevojën për promovimin e qasjes në edukimin e barabartë transformues gjinor në edukimin e hershëm të fëmijërisëveçanërisht duke transformuar normat dhe stereotipet gjinore , drejt avancimit të barazisë gjinore. RrGK theksoi se projektligji duhet të nxjerrë në pah të paktën disa nga mekanizmat kombëtarë, komunalë dhe qendrorë të cilët mund të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore (p.sh. ABGj, Zyrtarët për Barazi Gjinore). RrGK gjithashtu rekomandoi që ligji të luftojë në mënyrë eksplicite stereotipet dhe gjuhën seksiste në tekstet shkollore.

Përveç kësaj, gjatë konsultimeve me OShC-të, RrGK rekomandoi që takimi i NK të MSA-së të përfshijë vëmendjen për t'i bërë kurrikulat dhe tekstet shkollore më transformuese gjinore.

RrGK filloi procesin e hulumtimit dhe përgatitjes së rekomandimeve më specifike për kurrikulat që do të lansohen si pjesë e një përmbledhjeje të politikave në vitin 2023, të mbështetur nga ADA.

Tutje, RrGK në përgjithësi e ka bërë rekomandimin që institucionet të mbahen më të përgjegjshme për mësimdhënien në lëndën e edukimit seksual në shkolla gjatë takimeve me MASHTI-n.Vëzhgimet joformale të anëtareve të RrGK-së dhe informacionet e raportuara në RrGK nga aktivistet e reja sugjerojnë se megjithëse edukimi seksual është pjesë e kurrikulës, mësuesit jo gjithmonë e mësojnë at. Së bashku me anëtaret përmes FGK-së, RrGK po e shqyrton më tej këtë në vitin 2023 dhe është në proces të përgatitjes së rekomandimeve më specifike.

## Vlerësimi i punës së RrGK-së

RrGK monitoron dhe vlerëson punën e vet në disa mënyra. RrGK ka zhvilluar një Databazë të Monitorimit dhe Vlerësimit me qëllim që të përcjellë progresin në indikatorët e rezultateve të menjëhershme *(output)*, objektivat dhe nivelin e ndikimit me kalimin e kohës, bazuar në Strategjinë e RrGK-së. Stafi e përditëson rregullisht databazën me të dhëna lidhur me indikatorët, gjë që mundëson raportimet semestrale tek anëtaret dhe këtë raportim vjetor. Meqenëse ky është viti i fundit i Strategjisë aktuale të RrGK-së, stafi i RrGK-së gjithashtu përpiqet të vlerësojë progresin në Strategji, bazuar në bazat dhe objektivat e vendosura, dhe këto rezultate janë përfshirë në këtë raport.] Çdo vit, gjatë Takimit Vjetor të RrGK-së, anëtaret, partnerët dhe palët e interesuara vlerësojnë punën e RrGK-së përmes një ankete anonime. Edhe këtë vit, ata e kanë vlerësuar shumë pozitivisht punën e RrGK-së, siç ilustrojnë grafikët e mëposhtëm:


Si i vlerësoni shërbimet e RrGK-së ndaj jush?
15%
0%
85%
Shumë të dobishme
Të dobishme
Pak të dobishme
Aspak të dobishme




Më konkretisht, më poshtë janë disa nga komentet e tyre:

*"Shërbimet e RrGK ndaj neve janë shumë të dobishme."*

*"RrGK vendi ku e ndjej personalisht vetën të fuqishme."*

*"Mbledhjet e Rrjetit të Grave të Kosovës janë shumë të vlefshme mbani aktive anëtaret dhe jemi të njoftuara për çdo gjë."*

*"Stafi i RrGK-së janë komunikuese, mikpritëse dhe profesionale."*
*"Puna e RrGK-se reflekton çdo herë e poashtu edhe në vitin 2022, pozitivitet në drejtim të të drejtave të grave në shtetin tonë, poashtu në ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve si në aspektin organizativ ashtu edhe në avokim."*

*"Gjatë vitit 2022 RrGK ka realizuar shumë iniciativa, ndryshimin e shumë politikave dhe avancimin e ligjit për barazi gjinore."*

# Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2022

Tabela e mëposhtme përmbledh të ardhurat dhe shpenzimet e RrGK-së në vitin 2022. Për prezantim më të thjeshtë, të gjithë numrat janë rrumbullakosur në euron e plotë të afërt. Gjendja e mbetur do të bartet në vitin 2023.

| Donatori (Periudha e zbatimit) | Titulli i nismës | Fondet nga viti 2021 | Fondet e pranuara në vitin 2022 | Gjithsej të ardhura | Shpenzimet | Bilanci |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Bashkëpunim (01.01.2018-28.02.2021), bashkëfinancuar nga Sida (01.03.2021-28.02.2025) | Avancimi i mëtejmë i të drejtave të grave në Kosovë II | 502,914 | | 502,914 | 138,062 | 364,851 |
| KE, bashkëfinancuar nga Sida përmes Kvinna till Kvinna (23.03.2018-28.02.2022) | Fuqizimi i OshC-ve në Luftimin e Diskriminimit dhe Avancimin e të drejtave të grave në punë | 92,858 | 105,782 | 198,640 | 153,737 | 44,903 |
| Zyra e BE-së në Kosovë (20.12.2018-20.12.2022) | Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë | 87,525 | 112,877 | 200,402 | 200,402 | 0 |

| Donatori (Periudha e zbatimit) | Titulli i nismës | Fondet nga viti 2021 | Fondet e pranuara në vitin 2022 | Gjithsej të ardhura | Shpenzimet | Bilanci |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KE, bashkëfinancuar nga Sida përmes REACTOR – Research in Action (01.03.2020-30.04.2023) | Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të Anëtarësimit në BE | 23,414 | 33,106 | 56,520 | 42,696 | 13,823 |
| Zyra e BE-së në Kosovë bashkëfinancuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna (01.09.2021-30.06.2023) | Rritja e Kapaciteteve dhe Qëndrueshmërisë së OshC-ve për përparimin e Barazisë Gjinore në mes të Pandemisë COVID-19 | 351,884 | | 351,884 | 162,904 | 188,980 |
| Zyra e BE-së në Kosovë (13.03.2020-12.11.2022) | Përkrahje në zbatimin e PVGj II dhe integrimin e perspektivës gjinore | 6,127 | 24,494 | 30,621 | 23,800 | 6,822 |
| Fondacioni Kvinna till Kvinna (01.01.2021-31.12.2023) | Mbështetje Institucionale për strategjinë e RrGK për vitet 2019-2022 dhe 2023 - 2026 | 5,629 | 75,824 | 81,452 | 35,588 | 46,018 |

| Donatori (Periudha e zbatimit) | Titulli i nismës | Fondet nga viti 2021 | Fondet e pranuara në vitin 2022 | Gjithsej të ardhura | Shpenzimet | Bilanci |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fondacioni Kvinna till Kvinna (01.04.2019-31.12.2021) | Financimi i Lëvizjes së Grave në Ballkanin Perëndimor | 2,211 | | 2,211 | | 2,211 |
| ADA dhe Sida përmes Qendrës për Hulumtime dhe Politikëbërje (QHP) (01.11.2022 – 01.03. 2027) | Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi (Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjinor, Faza II) | | 54,653 | 54,653 | 2,271 | 52,382 |
| ADA dhe Sida përmes QHP (01.11.2019-31.07.2022) | Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinor në BP dhe në Republikën e Moldavisë | 9,607 | 12,281 | 21,888 | 21,888 | 0 |
| ADA përmes Qendrës Autonome të Grave (01.12.2019-31.12.2022) | Institucionalizimi i Rehabilitimit Cilësor dhe Shërbimeve të Integrimit | 35,313 | 40,187 | 75,500 | 75,500 | 0 |

| Donatori (Periudha e zbatimit) | Titulli i nismës | Fondet nga viti 2021 | Fondet e pranuara në vitin 2022 | Gjithsej të ardhura | Shpenzimet | Bilanci |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për të Mbijetuarat e Dhunës | | | | | |
| ADA përmes UNFPA (01.05.2021-30.11.2022) | Zbatimi i planit të punës të financuar nga UNFPA në lidhje me Planin e Përbashkët të Zhvillimit 2021-2025 të Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (RKSKB 1244) | 22,477 | 23,104 | 45,581 | 44,540 | 1,041 |
| KE përmes UN Women – T'i japim fund dhunës ndaj grave n (01.09.2021-01.03.2023) | Përmirësimi i kapaciteteve organizative të strehimoreve në trajtimin e dhunës seksuale duke përfshirë gratë nga minoritetet | 3,393 | 25,530 | 28,923 | 13,580 | 15,343 |

| Donatori (Periudha e zbatimit) | Titulli i nismës | Fondet nga viti 2021 | Fondet e pranuara në vitin 2022 | Gjithsej të ardhura | Shpenzimet | Bilanci |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fondi i Sigrid Rausing Trust (01.06.2021-31.05.2022) | Mbështetje Institucionale | 103,046 | 175,243 | 278,288 | 189,389 | 88,900 |
| Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) (21.12.2021-22.10.2022) | Vlerësimi i avancimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik të grave në bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë | 4,936 | 33,560 | 38,496 | 38,496 | 0 |
| Fondacioni Zemra dhe Dora | Mbështetje e përgjithshme | 2,296 | 4,528 | 6,824 | 0 | 6,824 |
| Altrusa | Praktika e grave të reja | 881 | | 881 | 0 | 881 |
| Donacione për RrGK | Fondi i qëndrueshmërisë | 12,734 | 9,128 | 21,862 | 6,058 | 15,650 |
| Gjithsej | | 1,267,244 | 730,296 | 1,997,540 | 1,148,911 | 848,629 |

## SHPËRNDARJA E SHPENZIMEVE NË VITIN 2022



AUDIT & CONSULTING ASSOCIATES

## INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

**To the Management of Kosovo Women's Network**

***Opinion***

We have audited the accompanying financial statements of Kosovo Women's Network, which comprise the statement of financial position as at December 31, 2022 and the statement of profit or loss, statement of changes in fund balances and statement of cash flow for the year then ended, and other explanatory notes.

In our opinion, the financial statements referred to above present fairly, in all material respects, the financial position of Kosovo Women's Network as of December 31, 2022, results of its operation and the cash flow for the year then ended in conformity with actual lows.

***Basis for Opinion***

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISAs). Our responsibilities under those standards are further described in the Auditor's Responsibilities for the Audit of the Project financial report section of our report. We are independent of the Organization in accordance with International Ethics Standards Board for Accountants Code of Ethics for Professional Accountants (IESBA Code), and we have fulfilled our other ethical responsibilities in accordance with these requirements. We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

***Responsibilities of Management and those charged with Governance for the financial statements***

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with the International Financial Reporting Standard and the internal controls that the management deems necessary to enable the preparation of financial statements without material misstatement due to fraud or error.

For the financial statements preparation, management is responsible for assessing the organization's ability to sustainability in the future, disclosing, as necessary, future sustainability issues and using the accounting continuity principle unless management intends to liquidate the Organization or Interrupt the operation, or there is no other possible alternative than to do it.

Those charged with governance are responsible for overseeing the Organization's financial reporting process.

***Auditor's Responsibilities for the Audit of the financial statements***

Our objectives are to obtain reasonable assurance about whether the financial statements as a whole are free from material misstatement, whether due to fraud or error, and to issue an auditor's report that includes our opinion. Reasonable assurance is a high level of assurance, but is not a guarantee that an audit conducted in accordance with ISAs will always detect a material misstatement when it exists. Misstatements can arise from fraud or error and are considered material if, individually or in



RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS • KOSOVO WOMEN'S NETWORK • MREŽA ŽENA KOSOVA

total, they could reasonably be expected to influence the economic decisions of users taken on the basis of these financial statements.

As part of an audit in accordance with ISAs, we exercise professional judgment and maintain professional skepticism throughout the audit. We also:

- Identify and assess the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error, design and perform audit procedures responsive to those risks, and obtain audit evidence that is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion. The risk of not detecting a material misstatement resulting from fraud is higher than for one resulting from error, as fraud may involve collusion, forgery, intentional omissions, misrepresentations, or the override of internal control.

- Obtain an understanding of internal control relevant to the audit in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the Organization's internal control.

- Evaluate the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates and related disclosures made by management.

- Conclude on the appropriateness of management's use of the going concern basis of accounting and, based on the audit evidence obtained, whether a material uncertainty exists related to events or conditions that may cast significant doubt on the Organization's ability to continue as a going concern. If we conclude that a material uncertainty exists, we are required to draw attention in our auditor's report to the related disclosures in the financial statements or, if such disclosures are inadequate, to modify our opinion. Our conclusions are based on the audit evidence obtained up to the date of our auditor's report. However, future events or conditions may cause the Organization to cease to continue as a going concern.

We communicate with those charged with governance regarding, among other matters, the planned scope and timing of the audit and significant audit findings, including any significant deficiencies in internal control that we identify during our audit.

Astrit Musa – Statutory Auditor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtine, Kosove
April 12th, 2023

# Rreth nesh

## Bordi i Drejtorëve të RrGK-së

Nermin Mahmuti, Kryesuese e Bordit
Feride Rushiti, Drejtore Ekzekutive, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës (QKRMT)
Shqipe Malushi, Aktiviste
Vjosa Dobruna, Aktiviste për të Drejtat e Grave
Zana Hoxha, Drejtore Ekzekutive, Artpolis
Belgjyzare Muharremi, Anëtare nderi

## Bordi Këshillëdhënës i RrGK-së

Behar Selimi
Delina Fico
Lepa Mladjenovic
Marte Prekpalaj
Rachel Wareham

## Stafi i RrGK-së në vitin 2022

Adelina Berisha, Menaxhere e Programit për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore

Adelina Tërshani, Zyrtare e Programit për Fuqizimin Ekonomik të Grave dhe BPGj
Alba Loxha, Menaxhere për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Komunikim
Albana Isufi Jashanica, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun
Arbenita Kllokoqi, Zyrtare për Financa (nga muaji Qershor)
Ariana Kasapolli Selani, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun (nga muaji Tetor)
Aurora Maxharraj, Hulumtuese
Besa Shehu, Menaxhere Financiare dhe Administrative
Besarta Breznica, Koordinatore e Programit për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore
Desumena Laçi, Zyrtare për Financa
Donjetë Berisha, Menaxhere e Fondit të Grave të Kosovës
Ejona Neziri, Hulumtuese, (Shkurt- Qershor)
Eranda Gashi, Koordinatore e Projektit, Fondi i Grave të Kosovës
Erin Brown, Vullnetare (Janar- Qershor)
Ernera Dushica, Koordinatore e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor
Etleva Malushaj, Koordinatore e Projektit
Gentiana Murati Kapo, Menaxhere e Granteve dhe Eksperte për Zhvillimin e Kapaciteteve
Gjylymser Nallbani, Asistente e Projektit, Fondi Grave të Kosovës (Janar- Qershor)
Gresë Sermaxhaj, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun (Janar- Qershor)
Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive
Jehona Tupalla, Mirëmbajtje, Logjistikë & Asistente Shoferi

Kaltrina Zhushi, Koordinatore e Projektit, Fondi i Grave të Kosovës
Laura Katona, Zyrtare për Financa (Janar-Maj)
Loreta Suka, Përkthyese
Lucy Maycox, Vullnetare
Luljeta Mehmeti Osmaj, Menaxhere Financiare (nga muaji Nëntor)
Marsejda Halilaj, Vullnetare
Mimoza Gojani Grezda, Zyrtare për Financa/Kontabiliste
Mirjeta Dibrani, Asistente Administrative dhe Logjistike
Nicole Farnsworth, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimit
Rita Berisha, Koordinatore e Projektit, Fondi i Grave të Kosovë
Rudina Voca, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun (Janar- Qershor)
Valbona Nuredini, Zyrtare për Financa (nga muaji Dhjetor)
Valmira Rashiti, Zyrtare për Integrim të Perspektivës GJinore
Viona Krasniqi, Monitoruese, Asistente ligjore
Zana Rudi, Menaxhere e Programit

## Kontributet individuale për RrGK-në

Personat në vijim kanë ofruar kontribut individual në përkrahje të punës së RrGK-së: Dennis and Katharine Luster, Elizabeth Kohnen, Noah Pearson, Jimmy Vestin, Barbra Bearden, Adelina Tërshani, Zarife Selmani, Seo Rocket dhe Mirjeta Krasniqi.

## Organizatat anëtare të RrGK-së në vitin 2022

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 1 | Akademia e Grave Ndërmarrëse të Kosovës | Fushë Kosovë | Donika Iseni |
| 2 | Aksioni për Nëna dhe Fëmijë | Rr. Perandori Dioklecian, Nr.14, Tophane, Prishtinë | Vlorian Molliqaj |
| 3 | Alma | Rr. Shpëtim Bojku, Nr.1, Pejë | Shemsije Seferi |
| 4 | Alter Habitus | Prishtinë | Eli Gashi |
| 5 | Arta | Rr. Vetërniku 1, Behar Begolli, Nr.23, Prishtinë | Hafije Qyqalla |
| 6 | Art Without Limit (AWL) | Rr. Hyzri Talla, nr.H5/7, Bregu i diellit, 10000 Prishtinë | Ganimete Sava |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 7 | Artpolis | Rr. Shaban Polluzha, P.n., Prishtinë | Zana Hoxha |
| 8 | Assist Kosovo Center- ASSIST | Prishtinë | Visare Berisha |
| 9 | Asociacioni i Gruas Feminea AGF | Adem Jashari 124/8, Prizren | Shykran Berisha |
| 10 | Aureola | Prishtinë Kompleksi Avalla, B/I, Nr.4, Prishtinë | Sanije Grajçevci |
| 11 | Bardha | Prishtinë | Raza Sadrija |
| 12 | Begatit e Batllavës | Fshati Batllave, Komuna Podujeve | Magbule Statovci |
| 13 | Bliri | Drenas Rr. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Drenas | Mahije Smajli |
| 14 | Bleta e Pejes | Rr.Bellopoj Dimitrije Tucovic, Pejë | Arlinda Kastrati |
| 15 | Business Women Mitrovica | Mitrovicë Qendra e Kulturës, kati 5, Mitrovicë | Melihat Beshiri |
| 16 | Center for Education and Community Development - Friends | Mitrovicë Qendra e Kulturës, Kati i II-të, Mitrovicë | Valbona Sadiku |
| 17 | Centar Maninjske Zajednice | Graçanicë | Jelena Bulatović |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 18 | Dera e Hapur | Prishtinë Tringë Smajli, Nr. 72, Prishtinë | Belgjyzare Muharremi |
| 19 | Dita | Prishtinë | Afërdita Zeneli |
| 20 | Djepi i Buzëqeshjes | Rr. Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë | Time Zenuni |
| 21 | Dora Dorës | Rr. Mbreti Zog, Nr. 59, Prizren | Vjosa Curri |
| 22 | Down Syndrome Kosova | Rr.Ukshin Hoti, Pejton, Prishtine | Sebahate Beqiri |
| 23 | Drugëza | Rr. Adem Jashari, Skenderaj | Hana Zabeli |
| 24 | Duart e Artizanës Kosovare | Dardania 1, 60000, Gjilan | Valentina Kovani |
| 25 | Duart e Vyera “Dora” | Lipjan | Mihane Avdullahu |
| 26 | EcoKosWomen EKW | Rr. Hilmi Rakovica nr.31, 10000 Prishtinë | Magbule Hyseni |
| 27 | Education Code | Prishtinë | Mimoza Statovci |
| 28 | Eliona | Fshati Vraniç, Suharekë | Arife Kolgeci |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 29 | Elita - Centre for Education and Development | Lipjan | Luljeta Krasniqi Murati |
| 3029 | EMINA - Grupi i Grave Boshnajke | Rr. 7 Shtatori, Jakup Ferri, Mitrovicë | Fata Zatriqi |
| 31 | Era Fruit | Batllavë, Podujevë | Xhylie Statovci |
| 32 | EULOC - Organizata për Reforma Lokale | Shtëpia e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", Viti | Melihate Osmani (e autorizuar) |
| 33 | Fana | Rr. Zhuj Selmani, Nr. 103, Pejë | Fana Gashi |
| 34 | Fati Jonë | Prishtinë | Igballe Makolli |
| 35 | Femra Vizionare e Shekullit XXI | Prizren Fsh. Bregdrini, Has, Prizren | Marte Prekpalaj |
| 36 | Femrat Aktive të Gjakovës | Gjakovë Rr. Sulejman Vokshi, Nr. 1, Gjakovë | Valbona Doli Rizvanolli |
| 37 | Flaka | Rr. Skenderbeu, Lipjan | Melihate Dedushi |
| 38 | Flori | Henc, Fushë Kosovë | Hava Abdullahu |
| 389 | Foleja | Prizren Zahir Pajaziti, Nr. 9, Zyrja Nr. 5, Prizren | Gjyzel Shaljani |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 40 | Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (F.E.ZH.) | Bregu i Diellit - Zona e Lindjes, Ll. 12, Nr. 7, Prishtinë | Vjollca Zeqiri |
| 41 | Fondacioni për Zhvillim Social | Prishtinë | Laura Berisha |
| 42 | Forumi Demokratik i Gruas (FDG) | Pejë Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 103, Pejë | Myzafere Ibishaga |
| 43 | For Change/ Për Ndryshim | Ali Kelmendi, Prishtinë | Alba Hajdini |
| 44 | Girls Coding Kosova | Rr. Ganimete Tërbeshi, Nr. 2, Prishtinë | Blerta Thaçi |
| 5 | Glas Žena Parteš | Parteš | Vesna Dimić |
| 46 | Gratë e Bashkura për Sukses (GBPS) | Rr. Kadri Zeka Nr. 31, Prishtinë | Zejnebe Hasani |
| 47 | Gratë e Minatorëve | Fshati Suhodoll, Mitrovicë | Emine Tahiri |
| 48 | Gruaja Ashkane për Gratë Ashkanlike | Mitrovicë Rr. Shemsi Ahmeti, 40000, Mitrovicë | Gjyleshah Fetahu |
| 49 | Gruaja Bashkëkohore | Prizren Rr. Bajo Topulli, Nr. 7, Prizren | Fetije Mehmeti |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 50 | Gruaja Fermere | Rahovec | Habibe Haxhimustafa |
| 51 | Gruaja Hyjnore | Gjilan Rr. Sadullah Brestovci, Gjilan | Igballe Hajdari |
| 52 | Handikos Mitrovica | Mitrovicë | Myrvete Hasani |
| 53 | HANDIKOS, Femrat me Aftësi të Kufizuara | Dardania B 1/5, Prishtinë | Mehreme Llumnica |
| 54 | Have Hope- Kam Shpresë | Emin Duraku, Prishtinë | Arnisa Osmani |
| 55 | Hendifer | Ferizaj Rr. Ramadan Rexhepi, Nr. 1, Ferizaj | Fazile Bungu |
| 56 | Humanus Vita | Prishtinë Dardani, Prishtinë | Doruntina Gashi |
| 57 | Iniciativa e Femrës Kosovare | Gjakovë | Eranda Kumnova Baçi |
| 58 | Iniciativa e Pavarur e të Verbërve | Dardani, Prishtinë | Fatbardha Salihu |
| 59 | Iniciativa për Integrim të Komuniteteve (IPIK) | Pri Rruga Tirana A2/15. Prizren | Shemsije Krasniqi |
| 60 | Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) | Fshati Sfaraqak, Vushtrri | Zenel Bunjaku |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 61 | INJECT - Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi | Prishtinë Rr. Sadik Stavileci, pn, Prishtinë | Luljeta Aliu |
| 62 | Instituti per Dialog dhe Mosdiskriminim – Institute for Dialogue and Non-Discrimination | Prishtinë, rr. Bajram Kelmendi p.n | Rovena Klinaku |
| 63 | Instituti i Psikologjisë Aplikative "Alpha" | Prishtinë | Neki Juniku |
| 64 | Instituti Kosovar i Medias dhe Komunikimit - IKMK | Rruga B, nr.210, 10000 Prishtinë | Kaltrina Ajeti |
| 65 | Instituti Kosovar për Rend dhe Ligj (IKRL) | Ilir Konushevci, nr.102, Prishtinë | Florije Burjani |
| 66 | In Time | Rr. Ymer Prizreni, Gllogoc, Lipjan | Besmire Aliu |
| 67 | IPKO Foundation | Prishtinë | Abetare Gojani |
| 68 | Jeto Vepro dhe Krijo JVK | Rr.Njazi Azemi Nr 58 Prishtinë | Sabrije Basha |
| 69 | Kelmendi | Fshati Lipë, Zveqan | Valbona Kelmendi |
| 70 | Këshilli për Barazi dhe Edukim në Shoqëri | Prishtinë Holger Peterson 315, Prishtinë | Afërdita Bekteshi |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 71 | Klubi Social Jeto | Prishtinë | Vjosa Shehu |
| 72 | Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës (KGVK) | Bregu i Diellit, Rr. Gazmend Zajmi, Ndërtesa e Standardit, Prishtinë | Bajramshahe Jetullahu |
| 73 | Konvita | Dolak, Vushtrri | Merita Selimi |
| 74 | Kori i Grave LIRA | Prishtinë | Valire Buza |
| 75 | Kosovo Advocacy Group - KAG | Dardani 26/A, 10000 Prishtinë | Mimoza Gavrani |
| 76 | LEUSTINA | Fshtati Batllave Komuna Podujev | Selvete Statovci |
| 77 | Lulebora | Prishtinë Mentor Retkoceri, Nr. 9b, Prishtinë | Selvete Gashi |
| 78 | Lulishtja | Fshati Dabishevc, Prishtinë | Sadije Dulahu |
| 79 | Lulu's Dance Academy | Rr. Qazim Berisha Prizren | Sijeta Braha |
| 80 | LUNA | Prilluzhë, Vushtrri | Stanica Kovacevic |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 81 | Malësorja | Rr. Fan Stilian Noli nr.40, Prishtinë | Shehrije Gërbeshi |
| 82 | Mbrojë të Drejtat e Tua | Rruga Jashar Salihu, Pallati i Kultures Jusuf Gërvalla, Deçan | Shkelqim Shala |
| 83 | Medica Kosova | Rr. Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë | Veprore Shehu |
| 84 | MEDIKA BL | Kalabria, Prishtinë | Bukurije Leti |
| 85 | Me dorë në Zemër | Rr. Tirana, Lagjja e Boshnjakëve, Mitrovicë | Shqipe Qarkaj – Kadriu |
| 86 | Moravski Biser | Partesh | Dragana Petrović |
| 87 | Mundësia | Rr. Vëllezërit Dragaj, Nr. 4, Mitrovicë | Hasime Tahiri Hasani |
| 88 | Ne Jemi Pjesë e Botës | Rr. Lidhja e Pejës Pn, Pejë | Gjylfidane Morina |
| 89 | OJQ për Avokim dhe Riintegrim të Viktimave të Dhunës | Rr. Lidhja e Pejës, Fushë Kosovë | Violeta Berisha |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 90 | OJQ Drita e Llapit | Podujevë | Aferdita Murati |
| 91 | OJQ Fitore | Prishtinë | Fitore Gashi Sharraxhia |
| 92 | OJQ Fillo Sot/ST | Podujevë | Mirjeta Kadriu |
| 93 | OJQ "Jeta" Turiçec | Rr.Sejdi Reka ,Fshati Turiqec,Skenderaj | Drita Mala |
| 94 | OJQ Social Creativity | Prishtinë | Vlora Ademi |
| 95 | OJQ Step | Rr. Xhem Gostivari, Prizren | Arbnore Hoxha |
| 96 | OJQ Stina | Fshati Rekë, Kaçanik | Zarije Malsiu |
| 97 | Organizata Ndërkomunale e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar | Rr. Hysen Rexhepi, Pn, Prizren | Perparim Krasniqi |
| 98 | Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) | Rr. Zahir Pajaziti, Pn, Prizren | Antigona Shestan |
| 99 | Organizata per Integrim dh Zhvillim Social "Follow Up" | Prishtinë | Agmie Osmani |
| 100 | Organizata për Zhvillim dhe komunikim "URA SOCIALE" | Dëshmorët e Kombit, nr.13, Vushtrri | Mergime Jashari |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 101 | Parajsa Jonë | Babush i Muhaxherëve, Lipjan | Sylbije Sahiti |
| 102 | Partners Kosova Center for Conflict Management | Dardania, SU 1/2, Kati i tretë, Nr. 11, Prishtinë | Shukrije Gashi |
| 103 | Pro Med Kosova | Rr. Halim Aga nr.8, Gjilan | Valentina Rexhepi |
| 104 | Psikoterapeutet në Veprim | Rr. Dardania, Nr. 1, Gjilan | Sevdije Musliu |
| 105 | Qendra e Gruas "ATO" | Rr. Ëesli Clark Pn, Vushtrri | Fikrije Ferizi |
| 106 | Qendra e Grave Optimiste | Rr. Fehmi Agani 15, Prishtinë | Emine Mehmeti |
| 107 | Qendra e Grave për Zhvillim Rural | Bostan, Novobërdë | Shefkije Mehmeti |
| 108 | Qendra e Gruas Mami | Rr. Fehmi Agani, 52/9, Prishtinë | Agnesa Demaj |
| 109 | Qendra e Kosovës për Zhvillim dhe Integrim Multikulturor | Rr. Fehmi Agani, Nr. 17, Gjakovë | Elvane Qorri |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 110 | Qendra Edukative për Fëmijët me Nevojat e Veçanta | Rr. Abdulla Presheva, Nr. 6/8, Gjilan | Shpresa Sejdiu |
| 111 | Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) | Rr. Hamëz Jashari, 16 b/2, 10000 Prishtinë | Feride Rushiti Sebahate Pacolli |
| 112 | Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) | Nëna Terezë, Nr. 18/1, Prishtinë | Luljeta Demolli |
| 113 | Qendra për Fuqizimin e Gruas (QFG) | Skender Ceku 15 A, Prishtinë | Merita Mustafa |
| 114 | Qendra për Hulumtime dhe Politikë Gjinore (QHPGJ) | Rr. Josip Rela, 13/18, Prishtinë | Vjollca Krasniqi |
| 115 | Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria" | Rr. 28 Nëntori, Pn, Gjilan | Nazife Jonuzi |
| 116 | Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) | Rr. Imzot Nikë Prela /50, Prishtinë | Zana Asllani |
| 117 | Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Shtëpia Ime" | Rr. Astrit Bytyqi p.n., Ferizaj 70000 | Sevdije Kasumi Bunjaku |
| 118 | Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës (QMGF) "Raba Voca" | Rr. Riza Selaci, Nr. 12, Mitrovicë | Fidane Hyseni |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 119 | Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT) | Rr. Pashko Vasa, 11 A, Prishtinë | Teuta Abrashi |
| 120 | Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG) | 12 Qershori, nr16. Pejë | Ardita Bala |
| 121 | Qendra për Ndihmë Ligjore dhe Zhvillim Regjional – CLARD | Rr Bardhyl Qaushi nr.7, 10 000 Prishtinë | Nedzad Radoncic |
| 122 | Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë | Rr. Muharrem Fejza, c15/15, Prishtinë | Sevdije Salihu |
| 123 | Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave | Qendra Tregtare, Nr. 42, Drenas | Kadire Tahiraj |
| 124 | Qendra Rinore Obiliq | Obiliq | Zelushe Kelmendi |
| 125 | Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore (QTSGJ) | Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 54, Prishtinë | Arjeta Rexha |
| 126 | Qendra Psikosociale "Aureus" | Ulpiana, D1 Hyrja 8, Nr. 7, Prishtinë | Myrvete Ahmetaj |
| 127 | QSGF-P | Prizren | Jubilea Kabashi |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 128 | Renesansa - Shoqata e grave në përkrahje të luftës kundër kancerit të gjirit | Luigj Gurakuqi 139/5, Prizren | Violeta Pirana |
| 129 | Rikotta | Rr. Adem Gllavica, Nr. 48, Prishtinë | Pranvera Bullaku |
| 130 | Rona | Rr. Ilaz Agushi, Nr. 114, Prishtinë | Serbeze Sylejmani |
| 131 | Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës (RROGRAEK) | Rr. UÇK, Banesa Nr. 1, Prishtinë | Shpresa Agushi |
| 132 | Ruka + Ruci | Ugljare, Fushë Kosovë | Gordana Toskic |
| 133 | Speranza | Qendra e Kulturës "Rexhep Mitrovica", Mitrovicë | Ajhan Prekazi |
| 134 | Svet Andjela | Mitrovicë e Veriut | Vasiljka Vojinovic |
| 135 | Support Groups Kosova | Prishtine/ Eduart Lir nr.144 | Rita Zhubi |
| 136 | She Solutions | Rruga Xhemajl Mustafa, BB-1, h-5, Nr.14, Dardani Prishtine | Antigona Baxhaku-Idrizi |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 137 | Sundimi i Demokraciese ne Kosove/ADK | Podujeve,Orllan | Rexhep Zeka |
| 138 | Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA | Rr. Halil Sylejman Aga, Gjakovë | Mirlinda Kusari Purrini |
| 139 | Shoqata e Avokatëve NORMA | Rr. Afrim Vitija, Nr. 3/1, Prishtinë | Valbona Salihu |
| 140 | Shoqata e Biznesit te Grave - Dardana | Kamenicë | Kadrije Mustafa |
| 141 | Shoqata Bletare Melissa | Deshmoret Dervishaj nn. Istog | Kumrije Maxharraj |
| 142 | Shoqata e Bletareve Mimfa | Rr. Hasan Prishtina Nr. 02 Obiliq | Xhemile Krasniqi |
| 143 | Shoqata e Femrave me Aftësi të Kufizuara "Femrat për Femra" | Rr. Zahir Pajaziti, Pn, Prizren | Fjolla Vukshinaj |
| 144 | Shoqata e Femrave të Shurdhëra (SHFSH) | Rr. Ëilliam Volker, Nr.53, Prizren | Krenare Hajredini |
| 145 | Shoqata e Fermereve dhe Fermerëve "Rukolla" | Prugovc, Prishtinë | Sanije Berisha |
| 146 | Shoqata e Fermereve dhe Fermerëve "Shpresa e Llapit" | Podujevë | Selvete Fetahu |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 147 | Shoqata e Grave "Jeta | Deçan | Safete Gacaferri |
| 148 | Shoqata e Grave "Medica Gjakova" | Rr. Fadil Nimani, Nr. 34, Gjakovë | Mirlinda Sada |
| 149 | Shoqata e Grave Bletare (SHGB) "Okarina e Runikut" | Runik, Skenderaj | Fetije Smakaj |
| 150 | Shoqata e Grave Fatjona | Banjë, Malishevë | Fatime Limaj |
| 151 | Shoqata e Grave Fermere "Krusha e Vogël" | Krusha e Vogël, Bregdrini, Prizren | Dile Prekpalaj |
| 152 | Shoqata e Grave GORA | Rr. Haxi Zekaj, Nr. 20, Prishtinë | Sevdija Ramadani |
| 153 | Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut | Rr. Isa Boletini, Mitrovicë | Vetone Veliu |
| 154 | Shoqata e Gruas | Gjakovë | Qefsere Kumnova |
| 155 | Shoqata e Gruas "Arlinda" | Rr. Ruzhdi Shabani, Magure, Lipjan | Bedrije Krasniqi |
| 156 | Shoqata e Grave të Balaj "ELITA" | Rr. Mustaf Aliu, fshati Balaj, Ferizaj | Behrije Nuha |

| # | Organizata | Adresa | Përfaqësuesi/ja |
|---|---|---|---|
| 157 | Shoqata e Gruas “Gruri” | Rr. Valdet Xhemajli, Drenas | Valdete Hisenaj |
| 158 | Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë, të Punës dhe Luftës | Rr. Mbretëresha Teutë, Pn, Pejë | Ardiana Gorani |
| 159 | Shoqata e Mamive të Kosovës | Prishtinë (Klinika Gjinekologjike-Obstetrike QKUK) | Magbule Elezi |
